

**RAPORT**

**I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Për Programin e studimit BSc Shkenca Politiko-Administrative**

**Universiteti Privat "Albanian University"**

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

**Dr. Klejdi Kellici**

**PhD. Eltion Meka**

(Shtator/2019)

*Eltion Meka*


*Klej*



**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**Për Programin e studimit BSc Shkenca Politiko-Administrative**

| Tabela e të dhënave për programin e studimit |  |
|--|--|
| 1  | IAL Aplikues: Universiteti Privat "Albanian University"                            |
| 2  | Fakulteti që e ofron Departamenti i Shkencave Politiko - Administrative            |
| 3  | Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit Shkresë MASH Nr. 8981 Prot, datë 27.12.2005 |
| 4  | Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë VBA Nr.86, datë 21.09.2017                       |
| 5  | Titulli i programit të studimit: Bachelor në Shkenca-Politiko Administrative       |
| 6  | Cikli i studimit: Cikli i parë   |
| 7  | Kohëzgjatja e programit të studimit: 3 vite/6 semestra                             |
| 8  | Kreditet në total (ECTS): 180 ECTS   |
| 9  | Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/): Kohë të plotë        |
| 10   | Gjuha (shqip/tjetër): Shqip  |
| 11   | Programi ofrohet nga institucioni Po   |
| 12   | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera Jo                        |
| 13   | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): Jo   |
| 14   | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): Jo   |
| 15   | Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve 6                                    |
| 16   | Nr. Studenteve:<br>2017-2018 22<br>2018-2019 29                                    |

*Elton Meka*





**HYRJE****Të dhëna për programin e studimit Bachelor në Shkenca Politikio-Administrative**

Albanian University është një institucion privat i ndarë në tre fakultete. Fakulteti i Shkencave Shoqërore përbëhet nga katër departamente, ku njëri prej tyre, Departamenti i Shkencave Politikio-Administrative ofron programin Bachelor në Shkenca Politikio-Administrative. Ky program është miratuar nga MASR për hapjen e tij në 27/12/2005 (nr. Prot.8981). Më 17.02.2009 me Vendimin Nr. 3, Këshilli i Akreditimit jep një sërë rekomandimesh për programin të cilat venë në hap mangësitë në administrimin e programit dhe përmbajtjen e tij. Më 9/04/2009 me Urdher Nr. 77, MASR i jep programit akreditimin e parë me kushte sipas Vendimit Nr. 3 të Këshillit të akreditimit. Më 29.10.2010 me Vendimin Nr. 99, Këshilli i Akreditimit heq kushtet e vendosura nga Urdheri Nr. 77 duke u shprehur se: IAL ka bërë përmirësime në statutin e saj, duke qartësuar kompetencat e organeve kolegjiale; ka bërë përpjekje për te rekrutuar personel me kohe të plotë me tituj e grada; ka ngritur zyrën e sigurimit të brendshëm të cilësisë; ka lidhur disa marrëveshje me institucione të ndryshme për praktikantët e studentëve; dhe puna e bërë në fushën e kërkimit shkencor është premtuese për të ardhmen. Si rrjedhojë, programi akreditohet për hreë të parë nga MASR pa kushte me Urdhër Nr. 532 (27/11/2010).


Akreditimi i fundit (dhe ai i pari periodik) është marrë më 21/9/2017 (VBA nr.86) ku programi është akredituar për dy vite. Akreditimi i fundit konstatoi se programi i përmbushte “pjesërisht” standardet e cilësisë për programet e studimit të ciklit të parë, dhe ve në pah një sërë mangësish si mospërditësimi i kurrikulës së programit i bazuar të një studim tregu, ngarkesën e lartë të stafit akademik, kualifikimin jo të kënaqshëm të stafit akademik, dhe pamjaftueshmërinë e titujve akademik në bibliotekë. Disa nga këto mangësi janë reflektuar në ndryshimet e kurrikulës të cilat janë depozituar te MASR në datën 03/05/18, ndërsa një pjesë tjetër është reflektuar në RVB e përgatitur për ri-akreditimin aktual.

**GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)**

Përbërja e GVJ: Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën Dr. Klejdi Kellici dhe PhD Elton Meka si ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi. Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga koordinatore të teknike të ASCAL Xhiliola Bixheku dhe Aviola Bardhi

Me datë 30.07.2019 dërgohet në Institucion Draft Raporti i Vlerësimit të jashtëm i Hartuar nga ekspertet e vlerësimit. Më datë 07.08.2019 Institucioni sjell në ASCAL komentet në lidhje me Draft – RVJ. Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

*Elton Meka*






### Memo

Duam të falanderojmë grupin e punës për komentet e tyre, pasi na dhanë edhe ne mundësinë të reflektojmë dhe të rishikojmë vlerësimet tona. Paraprakisht duam të themi se kemi bërë disa ndryshime në vlerësimin tonë sipas komenteve tuaja. Po ashtu, ngelemi të bindur se në disa aspekte ato qëndrojnë. Në pjesën e mëposhtme kemi kthyer pergjigje sejcilit prej komenteve të ngritura nga ju:

- **Konsiderata të përgjithshme:** Në lidhje me aspektin gjuhësor duam të theksojmë se edhe ne vumë re disa gabime në shkrim sipas komenteve tuaja. Jemi munduar ti reflektojmë komentet në mënyrë që opinionet tona të jenë sa më të qarta.
- **Për rekomandimin A:** Ekspertet e jashtëm **bien dakord me komentin e IAL** në lidhje me rekomandimin A. Ky rekomandim nuk gjykon elementet e kurrikulës, por objektivat e programit. Si pasojë, konkluzioni i këtij rekomandimi është ndryshuar nga “është plotësuar kryesisht” në “është plotësuar plotësisht.” Ndryshimet tashmë reflektohen dhe në RVJ.
- **Për rekomandimin B:** Ekspertet e jashtëm **nuk bien dakord me komentet e IAL**. Së pari, pavarësisht përbërjes dhe kualifikimeve të grupit të punës që rishikuan kurrikulën, ndryshimi prej 8.3% nuk është i mjaftueshëm, pikërisht sepse nuk përmbush aspektet e tjera të këtij rekomandimi. Së dyti, lëndët ndërdisiplinore-integruese, si për shembull Sjellja Politike nuk është një lëndë e administrimit publik, por e shkencave politike. Ndërsa lëndët e tjera të përmendura në komentin e IAL si Financat Publike dhe Aftësi Manaxheriale janë lëndë me zgjedhje, e cila do të thotë se studentet zgjedhin ose njëerën ose tjetrën, dhe në rastin konkret sipas diskutimit me studentet gjatë vizitës në IAL rezultoi se studentet kishin zgjedhur Komunikimin Publik. Pra dy lëndë të përmendura nuk janë ofruar ende për studentët. Së treti, ekspertët i qëndrojnë konkluzionit të tyre original se programi ende vuan nga një numër i vogël lëndësh mbi fushën e administrimit publik. Edhe pse ka disa lëndë që prekin administrimin publik në mënyrë indirekt, në gjykimin tonë dhe në baze të analizës së sillabuseve, ka vetëm një lëndë të mirëfilltë të fushës dhe ndryshime të mëtejshme janë të domosdoshme.
- **Për rekomandimin C:** Ekspertet e jashtëm **nuk bien dakord me komentet e IAL**. Në tërësi, vazhdon të ketë një mospërputhje të dallueshme midis stafit akademik, specializimit të tyre, dhe lëndët që ata ofrojnë. Edhe në rastin e lëndëve të përmenduar nga komentet e IAL përputhja nuk është aq e fortë sa argumentohet. Për shembull, lenda Psikologjia Politike e cila ofrohet nga Znj. Nano nuk ka përputhje të fortë. Pedagogjia ka vetëm një diplomë bachelor në psikologji dhe një diplomë master në Zhvillimin Urban, dhe kjo nuk e kualifikon atë për të ofruar një lëndë në atë fushë, sidomos për faktin se Znj. Nano nuk ka kualifikimin akademik për Shkencat Politike. Lënda Elementet e Qeverisjes dhe Proceset Zgjedhore ofruar nga Znj. Pano po ashtu nuk ka përputhje të fortë. Edhe pse komenti i IAL shprehet se Znj. Pano ofron këtë lëndë prej 8 vitesh, Znj. Pano ka fituar titullin Doktor vetëm në vitin 2017, dhe në fushën e Historisë. Pra, përputhja nuk është tepër e fortë. Po ashtu, edhe pjesa tjetër e stafit nuk reflekton të ketë publikime shkencore në fushën e tyre të mësimdhënies.


*Elton Meka*





- **Për rekomandimin D:** Ekspertet e jashtëm **nuk bien dakord me komentet e IAL.** Plotësimi i rekomandimit D ishte një nga pikat më të dobëta të programit. Edhe komentet e ofruara nga IAL nuk reflektohen në evidencat e RVB, pasi stafi akademik nuk ka thuar fare mbështetje financiare për aktivitete shkencore (me përjashtim të një rasti të vetëm të Znj. Markut), ndërkohë që përfshirja e stafit dhe programit në projekte kërkimore brenda vëndit është i dobët, ndërsa jashtë vëndit nuk ka thuar asnjë bashkëpunim të kësaj natyre.
- **Për rekomandimin E:** Ekspertet e jashtëm **bien dakord pjesërisht me komentet e IAL.** Së pari, në RVJ ka patur një gabim në specifikimin e një databaze, ku në vënd të Questia është përmendura Quora. Ky gabim tashmë është rregulluar. Po ashtu, ekspertet bien dakord se databaza Questia ka një numër të mjaftueshëm titujsh në fushën e administrimit publik dhe shkencave politike, por jo për rastin shqiptar e cila vazhdon të jetë një mangësi e programit. Si rjadhohë, ekspertët kanë ndryshuar konkluzionin e tyre për këtë rekomandim nga nga “është plotësuar pjesërisht” në “është plotësuar kryesisht.”
- **Për rekomandimin F:** Ekspertet e jashtëm **nuk bien dakord me komentet e IAL,** pasi argumenti i ofruar nga IAL nuk është i mjaftueshëm.
- **Për rekomandimin G:** Ekspertet e jashtëm **nuk bien dakord me komentet e IAL.** Përfshirja e studenteve në veprimtarinë e departamentit është e realizuar, por angazhimi i tyre nuk përfshin aspektin kërkimor. Edhe pse përfshirja e studenteve të nivelit bachelor duhet të jetë minimale, diçka e tillë nuk reflektohet mjaftueshëm në evidencat shoqeruara nga RVB. Edhe akreditimi i vitit 2017 përmënd pikërisht përfshirjen e “studentëve në veprimtarinë kërkimore të departamentit.” Pra, rekomandimi është i plotësuar kryesisht, por jo plotësisht.
- **Për Konkluzione, fusha 1, pika 1,** ekspertet e jashtëm **bien dakord me komentet e IAL,** dhe ndryshimet janë reflektuar në RVJ.
- **Për konkluzione, fusha 1, pika 2-3,** ekspertet e jashtëm **nuk bien dakord me komentet e IAL,** por kanë bërë disa ndryshime në tekst të pikave 2-3 për të qartësuar konkluzionet.
- **Për fushën 2,** ekspertet e jashtëm **nuk bien dakord me komentet e IAL.** Në lidhje me përgatitjen akademike të stafit, ekspertët janë të qëndrueshëm në argumentin e tyre se stafi nuk ka përgatitjen akademike të duhur për fushën e administrimit publik. Stafi i përmëndur në komentet e IAL përfshin kryesisht individë me përvojë akademike në shkënca politike, jo administrim publik. Edhe pse eksperiencia e tyre profesionale në administratën publike mund të jetë e mjaftueshme, kjo nuk zhvlerëson faktin që përgatitja e tyre akademike në këtë fushë nuk ekziston.
- **Për fushën 4, pika 1,2,3,** ekspertët **nuk bien dakord me komentet e IAL.** Ashtu siç është theksuar dhe në rekomandimin e pikës E, infrastruktura dixhitale për ofrimin e literaturës nuk është e mjaftueshme. Ndërkohë në tekstin e fushës 4 është bërë një ndryshim i vogël për të reflektuar planet e universitetit për të ndërtuar një kampus qendror.
- **Për fushën 5, faqja 17 dhe 19,** ekspertët **bien dakord me komentet e IAL,** dhe kanë bërë ndryshimet e duhura në tekst.

*Elton Meta*





- **Për fushën 6, faqja 18, ekspertët bien dakord me komentet e IAL, dhe kanë bërë ndryshimet e duhura në tekst.**
- **Për fushën 7, faqja 23, ekspertët nuk bien dakord me komentet e IAL.** Mungesa e literaturës të përditësuar, dhe sidomos ajo e administrimit publik është një nga pikat e dobëta të programit.
- **Për fushën 7, Konkluzionet e vlerësimit fq. 24 Pika 2 & 3.1, ekspertët nuk bien dakord me komentet e IAL.** Ashtu siç është përmendur dhe në lidhje me rekomandimin e pikës B, numri i lëndëve me fokus në administrimin publik është tepër i ulët.
- **Për fushën 7, Konkluzionet e vlerësimit fq. 24-25 Pika 3.2, ekspertët nuk bien dakord me komentet e IAL.** Edhe pse ekspertët janë dakord me argumentin se legjislacioni shqiptar është i domozdoshëm për të kuptuar funksionin e administratës publike në Shqipëri, kjo në vetvete ofron vetem një përshkrim të legjislacionit. Atëhere, cili do ishte ndryshimi midis administrimit publik dhe studimit të drejtësisë kur studentët marrin vetëm një përshkrim të legjislacionit në fuqi. Sigurisht që edhe pjesa teorike e marrë nga literatura jashtë, jep kontributin e saj, por përsëri ajo çka rezulton nga një program i tillë është vetëm një përshkrim deskriptiv i administratës, pa njohuri shkencore të problematikave dhe arsyt e këtyre problematikave në rastin shqiptar. Po ashtu, mungojnë edhe studime rasti mbi administratën shqiptare problematika është studjuar në mënyre shkencore. Pra, krahasimisht me shkencat politike të cilat kanë një farë përgjithësimi në nivel global, administrimi publik dallohet nga specifikat e rastit përkatës. Për këtë arsye, literature eksiztuese nuk mjafton për të mbuluar nevojat e këtij programi.
- **Për fushën 7, Konkluzionet e vlerësimit fq. 24-25 Pika 3.3, ekspertët nuk bien dakord me komentet e IAL.** Argumenti se ndërthurja e administrimit publik me marrëdhëniet ndërkombëtare në rastin shqiptar janë tepër të integruara, është një argument jo i saktë. Pamvarësisht lidhjes midis këtyrë dy fushave, ato janë thujse të ndara komplet nga njëra tjetra. Administrimi publik përfshin analizat a veprimtarisë institucionale ku elementi i analizës është vetë administrata. Ndërsa marrëdhëniet ndërkombëtare analizojnë veprimtarinë midis shteteve. Pra, teoritë bazë, elementët e analizave, dhe konceptet e përdorura nga këto dy fusha janë krejtësisht ndryshe. Sidomos për një program bachelor, këto dy fusha duhet të dallohen qartë për studentët.
- **Për fushën 9, Konkluzionet e vlerësimit fq. 29 Pika 4, ekspertët bien dakord pjesërisht me komentet e IAL.** Ndryshimet janë reflektuar në tekst.

*Elton Meka*

*[Signature]*



## ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË

### I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit:

- A) Të parashikohet qartë në objektivat formuese të këtij programi mundësitë e parashikuara të punësimit të studentëve të diplomuar, mbështetur në të dhënat e punësimit të studentëve tashmë të diplomuar;
- B) Të vleresohet, rishikohet dhe përditesohet plani mësimor me më shumë lëndë të profilit dhe në përputhje me zhvillimet makroekonomike të viteve të fundit;
- C) Të rritet stafi akademik për një përputhje më të mirë të formimit akademik të tyre me profilin e lëndëve që ata mbulojnë;
- D) Të merren masa për kualifikimin e stafit përmes veprimtarive të brendshme institucionale dhe mbështetjes së tyre për pjesëmarrje në projekte dhe angazhim në veprimtari kerkimore kombëtare dhe ndërkombëtare;
- E) Të shtohet numri i titujve specifik të fushës së shkencave politike administrative në bibliotekë;
- F) Të rritet mbështetja financiare nga ana e institucionit për përditesimin akademik të stafit për natyrën specifike që ka ky program studimi dy-fushësh;
- G) Të shihet mundësia e përfshirjes më të madhe të studenteve të këtij programi studimi në veprimtaritë e Departamentit.

### II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- A) Për rekomandimin **A**, programi ofron objektiva formuese të qarta dhe i reflekton këto objektiva pjesërisht në kurrikul. Po ashtu, Zyra e Karrierës dhe Alumin mban statistika dhe kontakte me studentët e diplomuar. Objektivat e programit janë të ndara në dy grupe: **së pari**, të specializojë dhe të përgatitë studentët për tregun e punës; dhe **së dyti**, programi përgatit studentët për studime të mëtejshme në fushën e shkencave politike, administrimit publik dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.

#### **Rekomandimi është plotësuar.**

- B) Për rekomandimin **B**, edhe pse në datën 25/4/2018 Senati Akademik i Albanian University ka miratuar ndryshimin e kurrikulës së programit, ku ndryshim nuk është i mjaftueshëm për nevojat e programit ashtu siç rekomandohet dhe nga Bordi i Akreditimit. Ndryshimi jo vetëm se është tepër i vogël (8.3%), por këto ndryshime reflektohen më shumë në lëndë të përgjithshme ose shkenca politike, por jo në fushën e administrimit publik. Pra, aktualisht programi ka ende vetëm një lëndë të mirëfilltë mbi administrimin publik.

*Elton Meka*

*[Signature]*



**Rekomandimi plotësohet pjesërisht.**

- C) Për rekomandimin C, vazhdon të ketë një mospërputhje të dallueshme midis lëndëve dhe stafit akademik. Një numur i madh i lëndëve, të cilat janë edhe lëndë vjetore, si përshembull Psikologjia Politike, Histori e Ideve Politike, Elementet e Qeverisjes dhe Proceset Zgjedhore, Filozofi Politike, ofrohen nga pedagogë me përputhje të dobët ose me aspak fushën akademike të lëndës.

**Rekomandimi është plotësuar pjesërisht.**

- D) Për rekomandimin D, edhe pse institucioni ka tentuar në disa raste të përfitojë nga projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, vetëm në disa raste kanë qenë të sukseshëm, por edhe në ato raste fusha kërkimore ka qënë larg shkencave politike dhe administrimit publik. Në tërësi, programi ka probleme të theksuara në aspektin e kërkimit shkencor.

**Rekomandimi nuk plotësohet.**

- E) Për rekomandimin E, departamenti ka shtuar numrin e titujve specifik për fushën e studimit, por këto shtesa i përkasin fushës së shkencave politike. Sipas RVB vetëm vitin e fundit akademik janë shtuar 11 tituj. Programi po ashtu ofron akses në databazën Questia. Megjithatë, programi vazhdon të ketë një numër tepër të vogël titujsh që përfshijnë administrimin publik për rastin shqiptar.

**Rekomandimi është plotësuar kryesisht.**


- F) Për rekomandimin F, vazhdon të mungojë financimi nga institucioni për stafin akademik. Evidenca e ofruar nga RVB (*Evidenca 5.2*) i referohet vetëm një rasti ku një prej stafit akademik i është rimbursuar një shumë e vogël për shenzimet. Gjatë vizitës në institucion u shpreh dhe nga stafi akademik se financime të kësaj natyre nuk kishte patur.

**Rekomandimi është plotësuar pjesërisht.**

- G) Për rekomandimin G, edhe pse numri i studentëve të angazhuar në veprimtarinë e departamentit është i lartë (112), angazhimi i tyre vjen kryesisht në formën e pjesëmarrjes vëzhgues në aktivitete shkencore si konference, seminare ose workshope. Përfshirja e tyre në aktivitete shkencore është e pakët, pasi për një program bachelori detyrimisht pjesëmarrja e studentëve në aktivitete shkencore ngelet e vogël.

**Rekomandimi është plotësuar kryesisht.**

Elton Meta





## ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

### 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Programi ka dy objektiva specifike: **së pari**, të specializojë dhe të përgatitë studentët për tregun e punës; dhe **së dyti**, programi përgatit studentët për studime të mëtejshme në fushën e shkencave politike, administrimit publik dhe marrëdhënieve ndërkombëtare. Në bazë të këtyre dy objektivave, programi i shikon studentët si studiues të fushës, si administrues të çështjeve politike, si hartues i politikave publike, dhe si njohës të strategjive politike. Mësimdhënia është e ndarë në disa forma, kryesisht në lëksione, seminare, detyra kursi, dhe projekte. Po ashtu, stafi akademik përdor metoda të ndryshme mësimdhënie, duke shfrytëzuar dhe teknologjinë. Vlerësimi i studentëve bëhen nëpërmjet një metode të standartizuar dhe të aplikuar nga i gjithë stafi akademik. Kërkimi shkencor thuhet se është në funksion të mësimdhënies, por në realitet kërkimi shkencor është tepër i ulët dhe përfshirja e studentëve po ashtu tepër e ulët (shikonë Pikën 10 të këtij raporti). Megjithatë, programi ka përfituar nga marrëveshjet ndërinstitucionale me institucione shtetërore dhe OJF brenda vendit.

Objektivat afatshkurtër të programit përfshijnë pjesën didaktike dhe kërkimore, por përveç pjesës didaktike e cila mund të adresohet në aspektin afatshkurtër, aspekti kërkimor duhet parë si objektiv afatmesëm dhe afatgjatë pikërisht sepse programi ka një boshllëk të ndjeshëm në këtë aspekt. Objektivat afatmesëm flasin për përmirësimin e teksteve bazë—diçka tepër pozitive duke patur parasysh mungesën e litarautrë në tregun shqiptar dhe për angazhimin e studentëve në kërkimin shkencor. Ndërkohë, objektivat afatgjatë flasin për konsolidimin e objektivave të mësipërme. Po ashtu, programi ofron një argument bindës për qëllimet e këtij programi duke u bazuar në nevojat e administratë publike si rrjedhojë e zhvillimit ekonomi/politik dhe procesit të integritimit evropian.

#### Vlerësimi sipas Standardeve

| Standardet/kriteret   | Vlerësimi sipas standardeve   |
|---|---|
| <b>I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>   |   |
| <b>Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>  |   |
| <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> | <p>Programi është hartuar në përputhje me qëllimet e Institucionit.</p> <p>Programi i studimit ka objektiva të qarta dhe të ndara në kategori si, njohuri teorike dhe praktike në përputhje me strategjinë e institucionit.</p> <p>Çdo vit, departamenti kryen një studim tregu i cili reflektohet në ndryshimin e kurrikulës.</p> <p>Departamenti përmes studimit të tregut të punës reflekton dhe zhvillimin e fundit lidhur kryesisht me administratë.</p> |


*Elton Mela*



|   |  |
|---|--|
| <b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.  |  |
| <b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>  |  |
| <p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>   | <p>Programi reflekton strategjinë e institucionit duke mbajtur në focus nevojat e studentit dhe përmirësimin të programit.</p> <p>Programi ofron njohuri bazë konform dhe programeve të ngjashme në fushën e shkencave politike. Po ashtu, programi përgatit studentët edhe për ciklin master.</p> <p>Programi ka në fokus aspektet teorike të fushës, dhe vetëm me përjashtim të disa lëndëve teknike ku formohen shprehi dhe njohuri mbi shkencat e administrimit.</p>   |
| <b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>   |  |
| <b>Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.</b>  |  |
| <p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar;</li> <li>kërkesat e punëdhënësve;</li> <li>një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</li> <li>numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</li> </ol>   | <p>Programi reflekton nevojat e tregut të punës, por jo domozdoshmërisht i plotësojnë ato. Kryesisht, programi synon të përgatisë studentë që mund të punojnë si në administratën publike dhe në spektorin privat. Por, në bazë të studimit të tregut që është kryer nga programi, përmenden vetëm pozicionë në administratën publike si mundësi reale, dhe ofrohet vetëm pak analizë mbi mundësi në sektorin privat ose OJF. Po ashtu, nëpërmjet një sërë shpembujsh, studimi i tregut të punës reflekton kërkesat e sektorit publik. Në përgjithësi, studimi është cilësor dhe nuk përmend shifra si numri i studentëve që mund të kenë mundësi pune pas diplomimit. Së fundmi, numri i studentëve të regjistruar në program është i vogël, por është i përafërt me institucione të tjera që ofrojnë të njëjtin ose programe të ngjashme studimi</p> |
| <b>Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</b>  |  |
| <p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>  | <p>Kurrikula e programit është mjaftë e bazuar në lëndë historike dhe antropologjike të cilat nuk bien ndesh me interesat kombëtare.</p> <p>Programi ndihmon në ruajtjen e vlerave kombëtare si nëpërmjet kurrikulës dhe nëpërmjet marrëveshjeve ndër-institucionale me Arkivin Qendror të Shtetit.</p>  |
| <b>Konkluzionet e vlerësimit:</b>   |  |
| <ol style="list-style-type: none"> <li>Programi i studimit është në përputhje me misionin e universitetit. Kurrikula e programit është ndryshuar si pasojë e studimeve të tregut, dhe programi ofron njohuri bazë. Për këto arsye, programi është në përputhje me standartet.</li> <li>Programi ka në vëmendje analizën e tregut të punës e cila shërben për ndryshimin dhe përmirësimin e kurrikulës. Megjithatë, analiza e tregut të punës mbështetet kryesisht tek evidentimi i pozicioneve në administratën publike, dhe nuk përmend shembuj jashtë administratës. Për këtë arsye, objektivat e programit kanë nevojë për rishqyrtim në mënyrë që të reflektojnë realitetin e mundësive të punës për studentët e këtij programi.</li> </ol> |  |

## 2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

*Elton Meka*





**Pjesa përshkrimore**

Fakulteti i Shkenca Shoqërore përbehet nga katër departamente, ndër të cilët dhe ai i Shkencave Politiko Administrative. Departamenti Sh.P.A. është përgjegjës për administrimin e kursit dhe dhënie e informacioneve përkatës për organizimin dhe vijimësinë e tij. Përpos kësaj secili prej kurseve të studimit ndiqet nga një pedagog përgjegjës që parashtron më pas problemet që mund të ketë kursi gjatë vitit.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Struktura akademike e Fakultetit

Fakulteti i Shkencave Shoqërore është i ndarë në katër njësi bazë, departamente. Këto janë:

a-Departamenti i Shkencave Politiko Administrative.

b-Departamenti i Shkencave Juridike

c-Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme

d-Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes

Struktura i përgjigjet logjikës dhe një ndarje funksionale mes disiplinave të ndryshme të shkencave shoqërore si dhe sasisë e numrit të studentëve në këtë Universitet.


- Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Gjatë dy viteve të fundit, Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative si dhe programi i Shkencave Politiko-Administrative ka patur vetëm ndryshime të vogla. Per vitin akademik 2017-18, Departamenti përbëhej prej 7 pedagogë PAE dhe 14 PAK. Ndër ata në kategorinë PAE, 1 mban titullin Prof. Dr., 4 atë Dr., 1 Doktorand dhe 1 me gradën MSc. Për kategorinë PAK, 1 mban titullin Prof. Dr., 1 Prof. Asoc., 4 Dr. Dhe 8 MSc. Ndërsa për vitin akademik 2018-19, Departamenti përbëhej prej 8 pedagogë PAE dhe 20 PAK. Megjithatë, vetëm një numër prej tyre janë angazhuar në mësimdhënie: janë angazhuar 11 pedagogë PAE duke përfshirë edhe 3 pedagogë nga departamente të tjera, ndërsa nga kategoria PAK vetëm 9 janë përfshirë. Ndonëse stafi për fushën e shkencave politike është i kualifikuar, stafi për fushën e administrimit publik vazhdon të tregojë mangësi në specializimin në përputhje me administrimin publik. Po ashtu, nga ana shkencore, stafi aktual vazhdon të tregojë një mangësi të madhe në prodhimin e punimeve shkencore në revista akademike të indeksuara në Thomson Reuters ose Scopus.

**3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit****Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

*Elton Meta*





Personeli akademik ndahet në dy kategori, efektiv dhe me kontratë. Nga të dhënat e përgjithshme rezultojnë se në nivel departamenti raporti mes kategorive të Personelit Akademik Efektiv me atë me Kontratë është relativisht i lartë. 8 pedagogë janë evektive ndërkohë që numri i pedagogëve të jashëm është 11. Numri i përgjithshëm i studentëve në këtë program studimi, është 29 e kështu raporti mes pedagogëve dhe studentëve është i pranueshëm. Shpërndarja e ngarkesës akademike nuk është lehtësisht e evidentueshme pas pedagogët mund të japin mësim dhe në programe të tjera të cilat nuk janë subjekt i këtij raporti. Në bazë të një kontrate pune që u pa, u vu re se numri i orëve mësimore në kontratën e punës ishte rreth 280, por nga bisedat që u bënë me pedagogët e brendshëm u theksua fakti se ngarkesa ishte e pranueshme dhe linte kohë për aktivitete të tjera shkencore. Po kështu pedagogët theksuan se nuk ngarkoheshin me punë suplementare administrative përveç asaj që rrjedh specifikisht nga aktiviteti i mësimdhënies apo i departamentit. Në raport me kriteret e punësimit, në bazë të deklarimeve u theksua fakti se kriteri kryesor është formimi dhe vlerësimi që pedagogët paraqesin në bazë të dokumentacionit e më pas intervista nga komisioni ad hoc që ngrihet nga departamenti për të marrë në intervistë kandidatët.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Tabelat në Aneks)


Nga të dhënat e vëna në dispozicion dhe bazuar në RVB rezultojnë se për dy vitet akademike që pjesë e këtij vlerësimi personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është si vijon:

- Për vitin akademik **2017 – 2018** kanë qënë të angazhuar 18 pedagogë, prej të cilëve 10 PAE dhe 8 PAK.
- Për vitin akademik **2018 – 2019** kanë qënë të angazhuar 20 pedagogë, prej të cilëve 11 PAE dhe 9 PAK. Ngarkesa mësimore mbulohet në masën 70% nga PAE dhe 30% nga PAK.

Numri i stafit akademik që është përfshirë në këtë program është i mjaftueshëm. Kjo sjell lehtësi në ndarjen e lëndëve dhe në ngarkesën të tyre. Sipas evidencave që kanë shoqëruar RVB dhe takimeve me stafin akademik dhe studentët gjatë vizitës në institucion u konstatuam se pedagogët nuk ofronin më shumë se dy lëndë në simestër dhe ngarkesa nuk i kalonte më shumë se 276 orë. Kjo gjë u shpreh edhe nga studentë të cilët shprehën kënaqësi mbi faktin që kanë patur mundësi të ekspozohen ndaj një numër të madh pedagogësh. Për vitin akademik 2018-19, dhe si pasojë e ndryshimit të kurrikulës, programi ka përfituar edhe nga angazhimi i disa pedagogëve PAE nga programet e tjera si Drejtësia, Psikologjia dhe Anglishtja.

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Plotëso Tabelat në Aneks, të cilat mund të plotësohen edhe nga verifikimi i tabelave të paqyruara në RVB)

*Elton Meha*





Numri i pedagogëve PAE gjatë dy viteve të fundit ka qënë thujse konstant. Për vitin akademik 2018-19, programi ka shtuar 1 pedagog me titullin Dr. (E. P., Ph.D. në Politikat e Shëndetit Publik). Ndryshimi më i madh është bërë në kategorinë PAK, numri i stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi ka qënë si vijon:

- Për vitin akademik **2017 – 2018** kanë qënë të angazhuar 18 pedagogë, nga të cilët 10 PAE: 1 Prof., 6 Dr., dhe 3 Msc dhe 8 PAK: 1 Prof. Asoc., 2 Dr., 5 Msc.
- Për vitin akademik **2018 – 2019** kanë qënë të angazhuar 20 pedagogë, nga të cilët 11 PAE: 1 Prof., 7 Dr., dhe 1 Msc dhe 9 PAK: 2 Prof. Asoc., 3 Dr., 4 Msc.

Edhe pse shumica e stafit PAE dhe PAK mbajnë titujt e duhur, si Prof. Dr., Prof. Asoc., ose Dr., shumë pak prej tyre janë të angazhuar në kërkim shkencor. Pra, detyrimet e tyre parësore janë mësimdhëna dhe detyrat administrative. Siç u shprehëm dhe me lart, përmirësimet në staf kanë qënë të vogla gjatë dy viteve të fundit.

Të dhënat sipas seksit (Tabelat në Aneks)

Për vitin akademik 2017-18 programi ka 11 persona të gjinisë femërore nga 21 anëtarë. Përkatësisht anëtarët efektivë të programit janë 3 persona të gjinisë femërore dhe 4 të asaj mashkullore. Në kategorikë e personelit akademik me kontratë ka 8 persona të gjinisë femërore dhe 6 të asaj mashkullore.

Për vitin akademik 2018-19, programi ka 10 persona të gjinisë femërore nga 20 anëtarë. Përkatësisht anëtarët efektivë të programit janë 5 persona të gjinisë femërore dhe 6 të asaj mashkullore. Në kategorikë e personelit akademik me kontratë ka 5 persona të gjinisë femërore dhe 4 të asaj mashkullore.

Të dhëna sipas moshës së personelit (Tabelat në Aneks)

Pjesa më e madhe e pedagogëve PAE janë në moshën 36-47 vjeç, ndersa mosha e shumicës së pedagogëve PAK është 46-55.


Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Kontratat e punës që disponon stafi akademik kanë një strukturë standarte. Ato janë të detajuara dhe tregojnë kohegjatjen e kontratës, detyrimet e palëve, orët e mësimi, dhe lëndët të cilat mbulon individi përkatës. I vetmi dallim midis kontratave ishte ai për stafin PAE dhe stafin PAK. E vetmja gjë që u vu në diskutim nga ekspertet ishte fakti që kontratat e stafit PAE ishin pa afat. Kontratat ishin në përputhje me legjislacionin e arsimit të lartë.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Stafi ndihmës plotëson kriteret e parashikuara, bile duhet theksuar se kjo është një pikë e fortë e Universitetit. Nga takimet që u bënë me stafin ndihmës e sidomos me studentët u pa që këta të fundit e ndjejnë se administrata e Universitetit i përgjigjet kërkesave të tyre.

*Elton Meka*





**Vlerësimi sipas Standardeve**

| Standardet/kriteret  | Përmbushja e standardeve   |
|--|--|
| <b>III - PERSONELI I INSTITUCIONIT</b><br><b>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.</b>   |  |
| <p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>  | <p>Procedurat për rekrutimin e stafit akademik ishin në përputhje me procedurat ligjore. Si procedure standarte, në fillim thirja publikohesh në media dhe online. Më pas, stafi akademik interviston disa nga aplikantët e përzgjedhur. Në fund, dokumentat përkatës të aplikantit depozitohen te Zyra e Burimeve Njerezore.</p> <p>Në bazë të evidencave që shoqëruan RVB, u konstatua se ngarkesa e pedagogëve ka qënë brenda normave ligjore. Ndërsa ndarja e ngarkesës mësimore nga PAE dhe PAK ishte 70% nga PAE dhe 30% për PAK për vitin akademik 2018-19. RVB nuk evidenton këto të dhëna për vitin akademik 2017-18.</p> <p>Institucioni ndjek disa procedure për vlerësimin e personelit. Së pari, personeli akademik vlerësohet vetë nga studentët pas çdo lende. Po ashtu studentët kanë dhe një tjetër mundësi për të shprehur opinionet e tyre nepërmjet fokus grupeve. Gjatë takimit me stafin akademik, stafi u shpreh se ata raportojnë në fund të çdo viti në lidhje me ecurinë e tyre profesionale, por ishte e paqartë se si vlerësoheshin ato raporte.</p> <p>Zyra e Burimeve Njerezore mban një dosje të secilit punonjës e cila përfshin të gjitha dokumentat e nevojshme për atë pozicion pune. Megjithatë, ekspertëve nuk i'u vu në dispozicion diçka që tregonte historikun e aplikimeve.</p> |
| <b>Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</b>   |  |
| <p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore "Doktor,, ose titullin akademik "Docent,,</p> | <p>Baza e të dhënave është dosja e pedagogut e cila ndodhet në Zyrën e Burimeve Njerezore. Dosja përfshin një CV, diplomat e stafit, njësimin e diplomës kur ajo është përfutur jashtë vëndit, dhe kopje të kartë së identitetit. Po ashtu, personeli PAK raporton mbi angazhimet e tjera të tyre jashtë Albanian University.</p> <p>Lista e pedagogëve disponohet nga Departamenti Përkatës e është evidentuar në RVB. Kjo përbehet nga stafi akademik, stafi mbështetës si sekretarja e departamentit, ose stafi administrative i Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit.</p> <p>Nuk u konstatua ky fakt përveç se u shpjegua se në bazë të nevojave institucioni shpall një thirrje publike e procedon me seleksionimin e kandidaturave në bazë të dosjes dhe intervistave.</p> <p>Titullarët e lëndëve janë përgjithsisht profesorë të asociuar, PAE dhe PAK. Mësimdhënia në disa raste kryehet evektivisht nga personel akademik me gradën Dr. ose MSC.</p>  |


Elton Meka





| <b>Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përbushjen e misionit të tij.</b>  |  |
|---|--|
| <p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>   | <p>Orët e seminareve zhvillohen në varësi të nevojave nga asistentë pedagogë.</p> <p>Burimet njerëzore shfrytëzohen në funksion të nevojave imediate më tepër se në raport me ato të objektivave. Në lëndët Psikologji Politike dhe Elementet e Qeverisjes dhe Sistemet Zgjedhore, formimi i pedagogut lektor nuk përputhet me natyrën e programit.</p> <p>Personeli akademik mbikqyr studentët në praktikat që ato kryejnë. Përgjithsisht studentët janë të kënaqur nga raporti që kanë me pedagogët dhe sidomos mundësitë që i jepen për praktika suplementare nga ato që ofron insitucioni në kuadër të kursit. Kështu disa prej pedagogëve të jashtëm mundësojnë pjesëmarrjen e studentëve në aktivitete ekstrakurrikulare si konferenca apo praktika pune.</p>  |
| <b>Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</b>  |  |
| <p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>  | <p>Nuk ka ndonjë strategji të qartë për kualifikimin e mëtejshëm të personelit akademik. U evidentua vetëm një rast kur janë ofruar kurse kualifikimi e ky është bërë në kuadrin e një programi Erasmus. Universiteti disponon një buletin shkencor/revistë Optime, në të cilën inkurajohet të, ndër të tjera dhe pedagogët e Dep. Sh.P.A. Duhet përmendur fakti se disa prej anëtarëve të departamentit kanë aplikuar, në emër të universitetit për projekte të ndryshme e rrelevante për fushat e studimit që ato mbulojnë. Përpos kësaj insitucioni ka nënshkruar një seri marrëveshjesh me simotra e organizata të tjera në Shqipëri për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta shkencore, me pjesëmarrjen e ndërsjelltë të presonelëve përkatës.</p> <p>Informacionet përkatëse janë të publikuara në faqen elektronike të institucionit.</p> |
| <b>Konkluzionet e vlerësimit:</b>   |  |
| <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kriteret për personelin plotësohen. Në përgjithësi institucioni ndjek praktika e procedura ligjore për rekrutim dhe punësimin e pedagoëve</li> <li>2. Institucioni ka e mban informacion mbi personelin gjë që reflektohet nga evidencat e dosjet personale të sejcilit prej tyre. Dosjet përmbajnë një informacion të gjerë e të plotë mbi gjendjen aktuale të pëdagogut dhe plotësohen në varësi të ndryshimeve.</li> <li>3. Kualifikimi i personelit nuk është politikë e vazhdueshme por plotësohet përmes programeve e iniciativave sporadike të Universitetit dhe iniciativave personale të pedagogëve. Ndofta kjo është tipike për departamentet e shkencave politike, ku diversiteti i fushave që studiohen e bën të vështirë të konceptohet e të vihen në zbatim politika formimi.</li> <li>4. Ngarkesa mësimorë për vitin akademik 2018-2019 mbulohet 70% nga PAE dhe 30% nga PAK, duke respektuar kështu standardet e cilësisë.</li> <li>5. Ngarkesa e stafit është në përputhje me standartet ligjore. Programi disponon një numër të konsiderueshëm stafi akademik i cili ndan lëndët mes tyre. Edhe gjatë takimit më studentët, ata u shprehën se në përgjithëse nuk kanë hasur një pëdagog më shumë se dy herë.</li> </ol> |  |

*Elton Meka*





#### 4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

##### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Gjatë vizitave u panë disa prej mjediseve mësimore e mbështetëse. Këto ishin dy salla studimi, biblioteka dhe një zyrë pedagogësh e departamentit. Përsa i përket mjediseve mësimore, ato janë të mjaftueshme si kapacitet por kishin nevojë për përmirësime. Gjatë vizitës në institucion, u vu re se një nga sallat e cila po përdoret dhe si mjedis mësimor kishte mungesë ajrimi. Po kështu në mjediset e brendëshme duket se mungon përkujdesja në kuptimin e mungesës e mirëmbajtjes së tyre, tavolinat e karriget e sallave ishin relativisht të vjetra. Biblioteka gjendej në katin e nëndheshëm i cili në mendimin tonë duhet rinovuar pasi ka lagështirë e kjo mund të ndikojë dhe në dëmtimin e librave. Ky mjedis përdoret në mënyrë të vazhdueshme nga studentët si mjedis shlodhje dhe studimi *e duhen marrë masa për ta rinovuar e bërë më të përshtatshëm për studentët*. Duhet njëkohësisht ndarë funksioni shlodhës nga ai studimor e biblioteka duhet të përdoret ekskluzivisht si mjedis studimi e konsultimi literature.

##### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Mjediset për Programin e studimit (Plotëso Tabelat në Aneks, të cilat mund të plotësohen edhe nga verifikimi i tabelave të paqyruara në RVB)
- Salla për leksione
  - Klasa për seminare
  - Salla për aktivitete promovuese
  - Salla për praktikë lëndore/ profesionale
  - Laboratorë për lëndët
  - Laboratorë informatike
  - Salla interneti
  - Salla për bibliotekë
  - Mjedis për fotokopjime, librari etj
  - Zyrë informacioni për studentët
  - Nyje hidrosanitare
- Mjediset për stafin:
- Mjediset për Dekanin/ kancelarin

*Elton Meka*

*Telet*



- Zyra për sekretarinë mësimore
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore
- Zyra për personelin akademik

Mjediset që ofron AU për studentët janë mëse të mjaftueshme. Sallat për leksione janë të bollshme e të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për mësimdhënie. Për vetë natyrën e kursit nuk ka salla për praktikë profesionale pasi që kjo e fundit nuk parashikohet në kurs. Bibloteka ka një sallë e cila shërben njëkohësisht si ambient shlodhje, leximi dhe studimi. Libraria e Universitetit gjendet në godinën e rrugës së Durrësit (ish gjykata e rrethit Tiranë). Po kështu ka një zyrë për informimin e studentëve. Në godinën qendrore të Universitetit ndodhet dhe salla kryesore ku zhvillohen aktivitetet promovuese dhe konferencat në institucion.

### Vlerësimi sipas Standardeve

| Standardet/kriteret  | Përmbushja e standardeve  |
|--|---|
| <b>V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI</b>   |   |
| <b>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</b>   |   |
| <p><b>Kriteri 1</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p> | <p>Studentët deklaruan se ndihmohen përgjithsisht nga pedagogët e lëndëve përkatëse me literaturë shtesë në formatin elektronik apo se dhe këshillohen nga pedagogët se ku mund të disponohet literature.</p> <p>Literatura e disponueshme në Biblotekë, përkon përgjithësisht me botimet që janë bërë në Shqipëri në fushën e Shkencave Politike. Megjithatë, vihet re një mungesë totale e literaturës mbi administrimin publik për rastin shqipëtar.</p> <p>Njëkohësisht studentët kanë akses në database Questia, për tu konsultuar me materiale në version pdf. Në këtë platformë studentët kanë një akses të gjërë mbi literaturë, edhe atë të administrimit publik, por jo për rastin shqiptar. Kërkesat për shtimin e zërave në bibliotekë vijnë nga drejtuesi i Fakultetit në bazë të kërkesave që bëjnë departamentet përkatëse.</p> <p>Bibloteka është e aksesueshme gjatë të gjithë ditës dhe shërben si sallë studimi.</p> |
| <b>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.</b>  |   |
| <p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit tëstudimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me</p>  | <p>Gjatë vizitës u panë dy ambiente studimi të cilat në raport me numrin e studentëve të programit në fjalë gjykohen si të përshtatshme për nga kapaciteti por duhen lyer e pajisur me sisteme ajrimi e kondicionimi.</p> <p>Mjediset e mësidhënies ishin të pajisura me kompjuter e</p>  |

*Elton Meka*

*[Signature]*



|  |   |
|--|---|
| <p>qëllimet e programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Labororët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në labororët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programstimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p><b>Kriteri 6</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>  | <p>projektorin përkatës.</p> <p>Janë brenda kushteve minimale të parashikuara në kriteret e parashikuara nga ASCAL.</p> <p>Ofrohet një laborator i cili për vetë natyrën e kursit të studimit gjykohet si i përshtatshëm.</p> <p>Disponon bazën materiale informatike.</p> <p>Praktikat profesionale zhvilloheshin jo vetëm në institucionet që korrespondojnë me profilin e kursit por dhe realizohen në kuadër të marrëveshjeve me institucione të tjera. Studentët u shprehën se kishin realizuar të paktën dy praktika të tilla, një në Arkivin e Shtetit e një në Institutin e Studimeve Politike.</p> |
| <p><b>Konkluzione të GVJ:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Insititucioni ofron shërbime ndaj studentëve si në raport me bibliotekën po ashtu dhe përmes aksesit të të gjithë studentëve në një database elektronike 'Questia'.</li> <li>2. Literatura përditësohet aq sa është e mundur nga botimet në shqip si dhe nga shtëpia botuese e Universitetit, por kjo nuk do të thotë se studentët gjithmonë kanë literaturë të përditësuar mbi shkencat politike dhe administrimin publik, pasi shumë tituj bashkëkohorë nuk janë të aksesueshëm në databazën Questia.</li> <li>3. Mjediset janë të përshtatshme si kapacitet dhe organizim por nevojitet të paktën rinovimi i tyre. Një prej mangësive që u vu re, të paktën në dy prej sallave, ajrimi i pamjaftueshëm. Biblioteka, e cila është në katin e nëndheshëm të godinës kërkon investime të paktën për sigurimin e ajrimit e eliminimin e lagështirës. Megjithatë, Albanian University tashmë është duke ndërtuar një kampus qendror i cili pritet të përmirësojë aspektet infrastrukurore të universitetit.</li> </ol> <p><i>Do të ishte e këshillueshme të paktën disiplinimi i sallës së Bibliotekës vetëm si sallë leximi e jo mjedis shlodhje, pasi kjo e fundit i kryen të dyja këto funksione.</i></p> |   |

## 5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Sikurse pjesa dërrmuese e Universiteteve private në Shqipëri, burimi i vetëm e më i rëndësishmi i të ardhurave janë tarifat e shkollimit që studentët paguajnë çdo vit. Një pjesë e vogël e tyre vjen nga aktivitete si mensa apo bar kafe. Kështu dhe për vetë specifikën e tij, Departamenti nuk gjeneron të ardhura shtesë nga konsulenca apo programe të ndryshme që mund të ofrohen nga donatorë. Vlen gjithsesi për tu përmendur që

*Elton Meka*



deri më tani, anëtarë të departamentit kanë aplikuar në disa projekte. Dhe pse projektet e dorëzuara nuk e kanë kaluar fazën e miratimit, vlen për tu vlerësuar përpjekja e Universitetit në përgjithësi dhe e Departamentit në veçanti për tu angazhuar në këtë drejtim. Situata financiare mbetet për tu vlerësuar në vijimësi, pasi duhet parë nëse numri i vogël i studentëve do të ndikojë më pas në strategjitë e insitucionit për të mbajtur në punë të njëjtin staf akademik.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):
- Grantet për kërkim – nuk ka
  - Konsulencat, shërbimet - nuk ka
  - Tarifat për dhe gjatë shkollimit- tarifa e shkollimit për një student BA është 1500 euro (tarifat e shkollimit përbejnë 99% e të ardhurave të programit)
  - Sponsorizimet - nuk ka
  - Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm) - Ofrohen në bazë të projekteve dhe marrëveshjeve të nënshkuara .
  - Donacionet, aktivitetet siguroese, fondacione etj - Nuk ka
  - Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj) – 170,000Lek (1%) për vitin akademik 2017-18, dhe 170,000Lek (1%) për vitin akademik 2018-19.
- Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Universiteti nuk ka burime të tjera financimi përveç atyre që vijnë nga tarifa e studimit. Përkatësisht për vitet 2017-8/2017-19, janë realizuar të ardhura në shifrat e 15.990.000 ALL dhe 12.975.000. Kostoja e një studenti sipas RVB llogaritet 900 euro në vit. Vërehet se nga viti 2017-8 në atë 2018-19, ka një rënie të të ardhurave megjithatë kjo nuk ka ndikuar në uljen e stafit apo rritjen e ngarkesës mësimore.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

### Vlerësimi sipas Standardeve

| Standardet/kriteret  | Përmbushja e standardeve   |
|--|--|
| <b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>  |  |
| <b>Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.</b>  |  |
| <b>Kriteri 1</b> Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;   | Inistitucioni ka kryer auditim të situatës së brendëshme financiare për vitin 2017-2018.   |
| <b>Kriteri 2</b> Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;  | Në raport nuk paraqiten të gjitha detyrimet financiare përveç shpjegimeve për përgjegjësitë e audituesit në kryerjen e procesit. |
| <b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë. | Nuk ka një pasqyrë të tillë për arsye të sipërcituara  |

*Elton Meka*





**VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR****Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.**

**Kriteri 1** Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;

**Kriteri 2** Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;

**Kriteri 3** Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.

Sipas raportit RVB, institucioni harton një raport financiar i cili miratohet nga Bordi i Administrimit. Raporti realizohet nga zyra e Auditit të Brendshëm dhe më pas nga një ekspert kontabël i jashtëm. Në Bord marrin pjesë tre anëtarë të trupës akademike.

Nga RVB pohohet se institucioni disponon të gjithë raportet financiare të kërkuara.

Është e vështirë të jepet një mendim për gjendjen financiare. Megjithatë, të ardhurat financiare për programin dhe institucionin vijnë 99% nga tarifat studenore. Kjo tregon se gjendja financiare është gjithmonë në varësi të numrit të studentve që kanë përzgjedhur programin. Me sa u pa nga raporti RVB, të ardhurat të realizuara duke marrë parasysh vetëm programin në fjalë, kanë pësuar një ulje prej rreth 300.000 lekësh. Rekomandimi jonë është që të diversifikohen të ardhurat për një stabilitet më të fortë financiar. Programet e Bashkimit Evropian janë një mënyre shumë e mirë për të aritur këtë qëllim.

**Konkluzionet e vlerësimit:**

1. Në faqen e ASCAL gjendet vetëm një raport përshkrimor mbi përgjegjësitë e Audituesit për procesin, drejtuar ortakëve të UFO shpk. Informacioni i vetëm disponohet nga RVB në formën e një deklarimi të thjeshtë të ardhurash nga tarifa që paguajnë studentët. Ajo që mund të vihet re nga RVB është ulja e të ardhurave në dy vitet e marra në konsideratë, dhe të ardhurat financiare bazuar kryesisht nga tarifat studentore.
2. Në Albanian University, ekziston nevoja për të diversifikuar të ardhurat. Kjo mund të arrihet nëpërmjet konsulencave dhe projekteve kërkimore. Për të krijuar stabilitet financiar, programi duhet të nisë një strategji të tillë.

**6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë****Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Cilësia sigurohet përmes njësisë së NJSBC. Qëllimi i njësisë është të monitorojë e të sigurojë përmbushjen e kritereve të brendshme të cilësisë dhe të atyre që imponon ligji. Njësia ka në dispozicion e kërkon të gjithë materialin e nevojshëm për përmbushjen e funksioneve të saj. Ajo varet nga Rektori i Universitetit. Funksionet e saj janë të parashikuara në statut e ato përmbledhen në paraqitjen e raportit vjetor, i cili evidenton: vlerësimin e procesit të mësimdhënies e atë shkencor, cilësinë e punës akademike e më pas jep

*Elton Meka*

*Kloy*



rekomandimet e nevojshme për zgjidhjen e problemeve. Kontrolli e vlerësimi bëhet në bazë të mbledhjes së të dhënave statistikore, pyetësorëve e analizës së tyre dhe fokus grupeve.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

- Sa anketime kanë bërë me studentët

Realizohen dy anketime në vit me studentët, një në përfundim të semestrit të parë dhe një në të dytin.

- Sa studentë janë anketuar

Sipas raportit dhe konstatimit janë anketuar 54% e studentëve.

- Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë

Të gjithë anketimet janë përpunuar. Nuk dolën në pah probleme pasi, në komunikim me studentët, dhe duke parë numrin e kufizuar të tyre, u vu re që studentët preferojnë ti drejtohen direkt drejtueses së departamentit për të zgjidhur çështje që kanë të bëjnë me mësidhënien.

- Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm


Rezultatet diskutohen në njësinë bazë, departamentin i cili i adreson ato e merr masat e nevojshme për të zgjidhur çështjet. Megjithatë, studentët deklaruan se ata përpunonin të zgjidhin pjesën më të madhe të problemeve, duke kontaktuar direkt drejtuesin e departamentit. Nga biseda që u zhvillua, pikërisht ky lloj komunikimi vlerësohej jashtë mase nga studentët.

U deklarua se NJSBC përdor si metodologji pune dhe fokus grupet me studentët. Këta të fundit përzgjidhen në mënyrë rastësore e më pas veprohet. Në bazë të fokus grupeve, NJSBC arrin të krijojë një ide më të thellë mbi problematikat e programit dhe mënyrat si ti ndryshojë ato. Po kështu një prej metodave të tjera ishte dhe kontrolli i pedagogëve gjatë mësimit. Dhe pse kjo përfshihej në raport, nga NJSBC u deklarua se ishte një formë evidentimi që nuk përdorej përveç se në raste të jashtëzakonshme, të cilat me sa duket nuk ishin manifestuar.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Në nivel programi, NJSBC bashkëpunon me Grupin e Sigurimit të Cilësisë në nivel Departamenti për rishikimin e kurrikulës dhe syllabuave dhe përgatitjen e raporteve. Ndryshimet e propozuara, raportet, rezultatet e pyetësorëve apo fokus grupeve, i përcillen departamenteve ku diskutohen dhe me pas i përcillen Senaatit Akademik. Ky është dhe bashkëpunimi kryesor mes dy njësive.

*Elton Meta*





- Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti (Tabela 4, Aneksi 4)

Pasi realizohen pyetësoret e studenteve bëhet përpunimi i tyre. Raporti që hartohet i dërgohet Përgjegjësit të departamentit, i cili me pas e diskuton në mbledhjet e radhës. Gjithashtu prej 2 vitesh NJSBC ka realizuar edhe pyetësorin e stafit akademik i cili pasi përpunohet i dërgohet drejtuesit të Departamentit. Nuk ishin evidentur raste problematike.

- Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Njësia prodhon dy raporte, një në përfundim të semestrit të parë dhe një në përfundim të vitit akademik. Më pas rezultatet diskutohen në nivel departamenti e nga ku dalin më pas detyrat për përmirësimin e punës.

- Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Politikat e përmirësimit përcaktohen në bazë të rezultateve të vlerësimit e më pas vepohet me korrigjimet përkatëse. Këto vlerësime vijnë nga pyetësorët apo analiza që i bëhet fokus grupeve. Megjithatë, sikurse u tha dhe më sipër, më tepër se kjo, funksionon raporti direkt që kanë studentët me drejtuesen e departamentit. Kjo është e kuptueshme kur numri i studentëve është relativisht i vogël.

#### Vlerësimi sipas Standardeve

| Standardet/kriteret   | Përbushja e standardeve  |
|---|--|
| <b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>   |  |
| <b>Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.</b>  |  |
| <p><b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve;</li> <li>Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit;</li> <li>Pyetje konceptuale;</li> <li>Intervista;</li> <li>Etj.</li> </ol> <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara);</li> <li>Dëgjime në auditor;</li> <li>Vlerësimi me nota/pikë;</li> </ol> | <p>Rezultatet e raportit janë ato që përdoren si referenca matëse për të parë ecurinë e programeve të studimit. Informacionet përfshihen në raportin e vetëvlerësimit institucional.</p> <p>Rezultatet janë të publikuara në faqen e Universitetit dhe ato përmbajnë të gjithë elementët e nevojshëm të vlerësimit.</p> <p>Sikurse u përmend më sipër, krahas sondazhit të vlerësimit të kryer nga studentët vepohet me fokus grupe. Sipas deklarimeve të studentëve, ata janë të prirur të shprehin më shumë problemet e tyre tek drejtuesja e Departamentit se sa në raport. Kjo vjen dhe për pasojë të numrit relativisht të vogël të tyre dhe për pasojë të disponibilitetit të drejtuesve të njësive në fjalë. Përsa i përket vlerësimeve mbi programet apo lëndë të ndryshme, u vu re që kriteret e vlerësimit për performancën e studentëve ishin standarte për të gjithë lëndët. Kjo e bën të lehtë analizën mbi këto kriteret. Njëkohësisht standartizimi mendoj se vjen pikërisht për të patur një mundësi më të madhe kontrolli mbi cilësinë.</p> |

*Elton Meka*




|  |  |
|--|--|
| <p>d. Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;</p> <p>e. Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Etj.</p>  |  |
| <b>VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË</b>   |  |
| <b>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</b>  |  |
| <p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p>   | <p>Institucioni është akredituar më parë. Kursi i studimit në fjalë ka marrë një akreditim tre vjeçar, 2016-19.</p>  |
| <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p>  | <p>NjsBC dhe organizimi i saj, është pikë e fortë e AU, si në nivel qendror dhe atë në bazë departamentesh. Për mënyrën se si u prezantua njësia, në takimin e kryer, mendojmë se ajo është një komponent i konsoliduar i institucionit.</p>                 |
| <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;</p>  | <p>Institucioni i jep mbështetje NjsBC e merr në konsideratë konkluzionet e hulumtimeve që njësia bën, duke patur parasysh se kjo e fundit është një komponent i rëndësishëm në raport me akreditimin.</p>   |
| <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;</p>  | <p>Në bazë të intervistave u pa se ka një raport të konsoliduar mes NjsBC dhe departamentit gjë që më pas reflektohet dhe në nivel institucional.</p>  |
| <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p>  | <p>Ekziston një frymë bashkëpunimi në institucion në lidhje me ritjen e cilësisë së programit, si me pedagoget dhe me grupin studentor.</p>  |
| <p><b>Kriteri 6</b> Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>   | <p>Strategjia dhe procedurat e përmirësimit të vazhdueshëm të programit bazohet kryesisht në pyetesoret dhe fokus krupet e studenteve si dhe nëpërmjet Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave, por nuk mund të themi sa ekziston një strategji e mirefilltë.</p> |
| <p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p>  |  |
| <ol style="list-style-type: none"> <li>1. NjsBC është një njësi e konsoliduar e cila nonitoron e menaxhon ruajtjen e kriterëve të cilësisë.</li> <li>2. Institucioni monitoron ecurinë e kurseve e programeve të studimit. Kjo tregohet jo vetëm nga vijimësia përse i përket ndryshimeve kurrikulare të pjeshme që bëhen për vit, por dhe nga përpjekja për të bërë një studim të tregut të punës. Raporti mbi tregun e punës është reflektuar deri diku dhe në kurrikulën e BA Shkenca Politiko-Administrative dhe pse për objektivat e ambiciet e kursit, kjo kurrikul do të duhet të përmirësohet më tej.</li> </ol> |  |

## **POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE**

### **7. Programi i studimit, organizimi i tij**

#### **Pjesa përshkrimore**

*Elton Meta*





**Terma reference:** misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Mësimdhënia e programit është mjaft e organizuar dhe i ofron studenteve dhe pedagogëve mundësinë për të përmirësuar cilësinë e saj. Viti shkollor është i ndarë në dy semestra, dhe në secilin semestër studentët duhet të plotësojnë 60 ECTS për të kaluar në vitin tjetër. Numri i lëndëve për semester është 6, ndërsa për vit është 12. Ngarkesa nuk është tepër e lartë, sidomos duke marrë parasysh se shumica e lëndëve që ofrohen nga programi janë vjetore, e cila do të thotë se në shumicën e rasteve studentët vazhdojnë të mbulojnë të njëjtën fushë nga simestri i parë tek i dyti. Kjo do të thotë se në total, numri i lëndëve për vit është më pak se 12. Megjithatë, ofrimi i lëndëve vjetore sjell dhe pasoja për studentët. Kur një student transferohen në një IAL të tjetër, atyre mund ti njihen vetem 5 ECTS nga 10 te cilat përbëjnë një lëndë vjetore. Në tërësi, programi është në përputhje me objektivat e programit, dhe plani mësimor është reflektuar në ndryshimin e kurrikulës në bazë të studimeve së tregut të punës. Në tërësi programi synon të përgatisë studentët si në aspektin teorik dhe në atë praktik për të punuar në administratën publike, ose për të vazhduar studimet e mëtejshme. Orët mësimore janë ndarë në një mënyrë të justifikueshme brenda dhe jashtë auditorit. Studentët kanë mundësi të pajisen me tekstet mësimore nëpërmjet bibliotekës të universitetit (në print ose databaza online) ose nëpërmjet pedagogëve të cilët ofrojnë tekstet bazë të lëndëve përkatëse. Po ashtu, studentet përfitojnë nga mbështetja e Zyrë së Këshillimit së Karrierës dhe nga Njësia e Sigurimit të Brëndshëm të Cilësisë e cila i jep studentëve mundësinë të japin rekomandime ose të kritikojnë aspektet e mësimdhënies.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi është miratuar në vitin 2005, dhe që prej asaj data ka kaluar disa faza akreditimit. Hapi i parë i këtij procesi ka qënë heqja e kushteve në lidhje me administrimin e programit dhe përmbajtjen e tij. Administrimi i programi është përmirësuar, dhe si pasojë në vitin 2009 MASR i ka hequr kushtet programit. Megjithatë, në lidhje me përmbajtjen e programit, mangësitë kanë vazhduar dhe këto janë reflektuar si në akreditimin e parë pa kushte të vitit 2010, si dhe në akreditimin e parë përiodik të vitit 2017 ku Bordi i Akreditimit u shpreh se programi kishte plotësuar standardet vetëm "pjesërisht". Ajo çka thekson ecurinë e këtij programi është fakti që nga njëra anë qëllimet dhe objektivat e programit kanë ngelur konstante, por nga ana tjetër programi nuk ka arritur të përmirësojë kurrikulën ose të ndryshojë atë në përputhje me rekomandimet e ngritura nga akreditimet e kaluara, sidomos ato në lidhje me mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fushën e administrimit publik.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

➤ 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor

*Elton Meta*

*Kej*



➤ 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor

- ✓ Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë (Ploteso Tabela e Planit ne aneks)

Programi përbëhet nga 180 ECTS dhe është i ndarë në tre vite shkollre, ku secili vit është i ndarë në dy simestra. Lëndët e programit janë të ndara në pesë kategori: lëndët bazë të cilat mbulojnë 20% të programit; lëndët karakterizuese me 52.2%; lëndët ndërdisiplinore/integruese me 12.8%; lëndët plotësuese me 11.7%; dhe detyrimet përmbyllëse me 3.3%. Po ashtu, lëndët janë të ndara në dy llojë—semestrare ose vjetore. Shumica e lëndëve janë të natyrës vjetore, ku secilës i përkasin 10 ECTS—ose ndryshe, një lëndë vjetore është e barabartë më dy lëndë simestrare (5+5 ECTS). Mirëpo, lëndët vjetore mund ti sjellin studentëve probleme në rastin se ata duan të transferohen në një institucion tjetër. Për arsyen se dy simestrat e lëndës vjetore janë tepër të ngjashëm, një institucion mund ta cilësojë të gjithë lëndën si një, dhe si pasojë studentit i transferohen vetem 5 ECTS. Diçka e tillë do çërontë mobilitetin e studentëve.

- ☑ Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- Për leksionet: 1455 orë në auditor dhe 1895 orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret: 600 orë në auditor dhe 550 orë punë e pavarur e studentit
- Për Labororet: 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikat lëndore: 45 orë në auditor dhe 55 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën Profesionale: 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar: 60 orë në auditor dhe 90 orë punë e pavarur e studentit


- ✓ Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Plotësoni Tabelën ne Aneks)

Në kuadër të përmbushjes së rekomandimeve nga Bordi i Akreditimit të vitit 2017, në fillim të vitit 2018-19 plani mësimor ka kaluar një ndryshim të vogël, ku sipas RVB ky ndryshim ka qenë 8.3%. Këto ndryshime janë miratuar nga Senati i Akademik më 25.4.2018 dhe është miratuar nga MASR më 5.06.2018. Ndryshimet reflektohen në kurrikulën e programit ku, numri i kredive për disa lëndë ka ndryshuar, disa lëndë më zgjedhje kanë kaluar në vitin e I-rë, dhe disa lëndë kanë ndryshuar emrin dhe janë bashkuar me lëndë të tjera. Ndryshimet janë në përputhje me objektivat e programit, por vihet re ende një mungese e madhe e lëndëve të cilat mbulojnë fushën e Administrimit Publik. Nga kurikula e re, vihet re vetëm një lëndë e mirëfilltë e fushes së administrimit publik, ajo e titulluar “Administrimi Publik dhe Politikat Publike”.

- ☑ Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Plotëso Tabelën ne Aneks)

Analiza e syllabuseve tregon një ndarje të tyre në dy grupe. Njëri grup përbëhet nga lëndë të cilat janë mirë-strukturuar, ofrohen nga pedagogje me eksperiencë në përputhje me lëndën, dhe literatura e përdorur është bashkohore edhe cilësore. Ndërsa grupi tjetër i lendeve, diku tek rreth 50%, përbëhet nga lëndë që nuk janë shumë në përputhje me programin (lëndë me karakter të theksuar historik), pedagogët në ndonjë rast nuk kanë eksperiencën e duhur për të ofruar atë lëndë, dhe literature e përdorur është tepër e vjetër ose jo shumë në përputhje me lëndën. Mund të përmënd disa lëndë që nuk janë në përputhje të plotë më elementet

*Elton Meta*





vlerësues, si për shembull, Psikologjia Politike ose Politikat e Ballkanit. Ndërsa, Administrimi Publik dhe Politikat Publike—e vetmja lëndë në përputhje me fushën e Administrimit Publik—por një lëndë e cila nuk ofron literaturë mbi rastin Shqiptar.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Sipas analizës së syllabus-ve ato tregojnë se i përmbahen kriterëve të mëposhtme. Për më tepër, syllabut e programit kanë adoptuar një format standart, e cila i jep një ngjashmëri të lartë me njëra-tjetrën.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Vlerësimi i syllabuve mund të themi se ka aspekte pozitive dhe negative. Ajo çka tregon përmirësim në përmbajtjen e syllabuve është struktura e tyre. Kjo ka sjellë lehtësi si për pedagogët edhe për studentët të cilët mësohen me një strukturë të ngjashme. Po ashtu, struktura e syllabuve përmban të gjithë komponentët e duhur sipas VKM 41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Problemi kryesor i syllabuve është në lidhje me përditësimin e tyre. Shumë prej lëndëve nuk ofrojnë literaturë të përditësuar, dhe ajo çka është më problematike është fakti se literatura mbi fushën e administrimit publik thuajse mungon.

### Vlerësimi sipas Standardeve

| Standardet/kriteret   | Përmbushja e standardeve   |
|---|--|
| <b>I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA</b>   |  |
| <b>Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>  |  |
| <p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p><b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p> | <p>Albanian University ofri programin Bachelor në Shkenca Politiko-Administrative. Programi është i akredituar nga MASR dhe është i organizuar në mënyrë të rregullt dhe të qartë. Programit përdor sistemin e kredive ECTS, nëpërmjet të cilës përcaktohen orët totale të mesimdhënsies, detyrimet e studentëve, dhe numri total i krediteve.</p> |

*Elton Meta*



|  |   |
|--|---|
|  | Programi i plotë përbëhet prej 180 ECTS dhe është i ndarë në tre vite. Cdo vit përbëhet nga 60 kredite.   |
| <b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>  |   |
| <b>Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.</b>  |   |
| <p><b>Kriteri 1</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p>  | <p>Njësitë kryesore ofrojnë informacion të mjaftueshëm mbi organizimin e programit. Ky informacion i jepet studenteve në fillim të vitit të I-rë. Po ashtu, gjatë vizitës në institucion, ekspertëve të jashtëm ju be i disponueshem informacioni I nevojshëm për vlerësimin e programit.</p> |
| <p><b>Kriteri 2</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p>   | <p>Ndarja e programit në lëndë me zgjedhje apo me detyrim ishte e qartë, dhe ky informacion I diskutua dhe ne takimet ballë-për-ballë më përfaqesues të programit.</p>  |
| <p><b>Kriteri 3</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;</p>  | <p>Ndarja e programit në leksione, seminare, orë pune të pavarur nga studentët, frakuentimin e programit dhe penalitet për mos-frekuentim u bënë të qarta ekspertëve të jashtëm gjatë vizitës në institucion.</p>   |
| <p><b>Kriteri 4</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikatat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.</p>   | <p>Syllabet e programit janë tepër të detajuara dhe të strukturuar në një format standard. Kjo e bën të thejshhtë leximin e tyre si nga ana e ekspertëve te jashtëm por edhe nga çdokush tjetër.</p>  |
| <b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b>   |   |
| <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Organizimi i programit është plotësisht në përputhje me standartet e vendosura, dhe tregon një mirëfunksionim të brëndshëm në ndërjen e programit në vite, simestra, numur kreditesh për lëndë dhe detyrimet e studentve për të kaluar nga viti në vit.</li> <li>2. Problem kryesor i programit është nga aspekti substancial i lëndëve. Për momentin vihet re një boshllëk i madh në numrin e lëndëve të cilat mbulojnë fushen e Administrimit Publik. Aktualisht, programi ofron vetëm një lëndë të mirëfilltë mbi administrimin publik, ndërkohë që lëndët e tjera ose e mbulojnë këtë fushë në mënyrë indirekte, ose e mbulojnë shumë pak. Në këtë aspekt, programi plotëson standartet vetëm pjesërisht.</li> <li>3. <b>Rekomandohet:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Të integrohet kurrikula e programit më mirë me programet e tjera për të përforcuar komponentin e Administrimit Publik. Lëndë të tjera të cilat mund të sjellin këtë funksion janë Hyrjes në të Drejtë Administrative si dhe vendosjen e lëndëve Qeverisje Lokale e Financa Publike si të detyrueshme, por edhe lëndë të tjera nga programet e Drejtësisë dhe Financës.</li> <li>➤ Pedagogët e lëndëve përkatëse duhet të ofrojnë literaturë më të përzgjedhur mbi administrimin publik. Nuk mjafton që për lëndë të tilla ti ofrohet studentëve teksti i Kushtetutës apo legjislacione të tjera bazë të vëndit. Staf i akademik duhet të pasurojë lëndët me lexime të mjaftueshme mbi administrimin publik.</li> <li>➤ Në kurs ka një komponent të ndjeshëm të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, gjë që del nga logjika e shpjegimit dhe justifikimit që jepet në përgjithësi për programin. Një prej zgjidhjeve do të ishte ndoshta reduktimi i lëndëve të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, për ti bërë vend komponentit administrativ të kursit.</li> </ul> </li> </ol> |   |

Elton Meka



## 8. Mësimdhënia

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Mësimdhënia është e ndarë në disa komponent. Pjese kryesore e marim leksionet me 1211 orë mësimdhënia gjatë 3 viteve, më pas vijnë seminarët me 473 ore, ndërsa pjesë tjetër vijnë nga projekte, detyra, praktike mesimore, dhe teme diplome për një total prej 1891 ore. Në bazë të kredive të lëndës, këto komponente mësimdhënie janë ndara proporcionalisht. Kontrolli i njohurive ka një metodë standarte të cilë programi e ka adoptuar, nga e cila 60% e notës së ponderuar vin nga provimi përfundimtar. Gjatë takimit më studentët ata u shprehen se sallat e mësimi ishin të pajisura me kompjutera dhe projektor te cilat përdoren për prezantimin e lëndës ose për prezantimet e studentëve. Në lidhje me cilësinë e programit, universitetit ofron disa mekanizma për të siguruar cilësinë e brendshme. Studentët kanë mundësinë të shprehin mendimet e tyre në dy formate—nëpërmjet një pyetësori anonim për secilën lëndë që ata kanë mbaruar dhe nëpërmjet fokus grupeve ku studentët diskutojnë gjërësisht mbi problematikat e tyre. Po ashtu, Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave detyron stafin akademik të rishikojë syllabet e lëndëve në mënyrë që të azhurnohet literatura dhe të rëflektohen ndryshimet e tregun të punës.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet (Tabela e Planit ne aneks):

Programi i cili përbëhet prej 180 ECTS ndahet në 1891 orë mësimdhënie. Pjesën më të madhe të orëve të mësimi e marim leksionet dhe seminarët. Kjo ndarje është standarte për të gjitha lëndët. Ndarja specifike e orëve për të gjithë programin reflektohet në Tabelën 9, në fund të këtij raporti.

- Leksione
- Seminare
- Ushtrime
- Laboratore
- Detyre
- Praktikë lëndore
- Praktikë profesionale
- Etj

Format e kontrollit të njohurive

Format e kontrollit të njohurive të studentit janë në varësi të lëndës. Megjithatë, programi ka adoptuar një format standard ku pjesa më e madhe e vlerësimit (60%) i dedikohet provimit përfundimtar, ndërsa pjesa e

*Elton Mehta*

*Kly*



ngelur (40%) vendoset vetë nga pedagogu. Pjese 40% ndahet në disa komponentë, si ndjekja e lëndës në mënyra aktive, plotësimi i detyrimeve (ushtrime, detyra/projekte) dhe testime të tjera gjatë vitit. Në mendimin tonë, ky lloj standartizimi jo gjithmonë është diçka e mirë sepse kufizon lirinë akademike sidomos në lëndë ku komponentët e vlerësimit të studentit do kërkonin një ndarje ndryshe. Megjithatë, kur stafi akademik u pyet mbi këtë çështje, ata u shprehën se kjo zgjedhje ishte në përputhje me udhëzimet e MASR. Studentët po ashtu u shprehën se janë tepër të angazhuar në aktivitetet e universitetit. Këto konstatime u bënë në bazë të Raportit të Vlerësimit të Brëndshëm dhe në bazë të bisedimeve gjatë vizitës në institucion.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Aktivizime të studentëve sigurohet nëpërmjet disa rrugëve. Universiteti ofron aktivite në nivel institucional, në nivel fakulteti dhe në nivel departamenti. Në të gjitha rastet studente kanë mundësi të përfitojnë nga këto lloj aktivitete. Sipas të dhënave në RVB (Tabela 17) dy vitet e fundit janë angazhuar rreth 112 studentë në aktivite shkencore. Megjithatë, cilësia e këtyre angazhimeve nuk pritet të jetë e lartë pasi vetë stafi akademik gjatë takimit me ta në ditën e dytë të vizitës institucionale u shprehën se studentët e bachelorit nuk mund të përfshihen thellë në kërkime shkencore për arsye se kërkimet shkencore kërkojnë një përgatitje më të lartë nga ana e studentit. Gjatë vizitës institucionale, edhe studentët u shprehën se kanë përfutuar nga këto lloj aktivitete shkencore si dhe aktivite të tjera nga Zyra e Karrierës dhe Alumnit.

## 9. Studentët


### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Programi frekuentohet nga një numër i ulët studentësh. Dy vitet e fundit programi ka shtuar 22 (2017-18) dhe 29 (2018-19) studentë të rinj. Programi pranon vetëm studentë me kohë të plotë, dhe studimet mund të zgjasin deri në 6 vjet (BA+MsC), duke përjashtuar periudhën ku një student mund të pezullojë ato. Studentët kalojnë nga një vit tek tjetri vetëm pasi të kenë akumuluar 50% të kredive të atij viti. Po ashtu studentët nuk pranohen në sesionin e parë të provimit përfundimtar të lëndës në rastin se kanë më shumë se 25% mungesa në seancat mësimore; kur studenti ka më shumë se 50% mungesa detyrohet të frekuentojë lëndën nga e para. Të gjitha detajet e programit i bëhen të ditur studentëve si në kontaktin e tyre të parë me Albanian University si dhe në javën e parë të çdo viti akademik (java orientuese). Pasi studentët kanë mbaruar studimet ata automatikisht bëhen pjesë e Alumnit me të cilët Zyra e Karrierës dhe Alumnit mban kontakte periodike.

### Vlerësimi i Tregues të matshëm:

*Elton Meka*





Procedurat e pranimit të studentëve

Studentët regjistrohen fillimisht në portalin on-line të maturës shtetërore. Më pas, për tu regjistruar në program studentët duhet të paraqesin dokumenta ligjore që tregojnë përfundimin e maturës shtetërore, nuk janë të regjistruar në nje IAL tjetër, plotësojnë kriteret e mesatares të vendosur nga MASR, plotësojnë kriteret e vendosur nga Albanian University, dhe dorëzojnë fotokopje të kartës së identitetit, diplomën e shkollës së mesme, certifikatën e maturës shtetërore.

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Cilësia e studentëve në hyrje është afër mesatarës të vendosur nga MASR.

Për vitin 2017-18 mesatarja ishte 7.05 (nga 19 studentë);

Për vitin 2018-19 mesatarja ishte 7.1 (nga 27 studentë);

Mesatarja dalëse ishte 7.02 për vitin 2016-17 dhe 6.8 për vitin 2017-18.

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare (Tabela e Planit ne aneks):

Për vitin shkollor 2017-18 janë regjistruar 22 studentë të rinj, 3 prej tyre janë studentë të transferuar. Ndërsa për vitin 2018-19 janë regjistruar 29 studentë, 2 prej tyre janë të transferuar.

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Nga 34 studentë të diplomuar vitin akademik 2017-18, nota mesatare dalese ka qenë 6.8.

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Mobiliteti i studentëve brenda vendit është i vogel. Vetëm 3 dhe 2 studentë për dy vitete e fundit respektivisht janë transferuar drejt programit bachelor ne shkenca polikiko-administrative.

Të dhëna për punësimin e studentëve

Për periudhën e të dhënave 2017-19, për programin shkenca politiko-administrative janë punësuar 34 studentë.

Numri total të diplomuarve

Për periudhën e të dhënave 2017-19, janë diplomuar 34 studentë.

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Për periudhën e të dhënave 2017-19, numri i të punësuarve në përputhje me diplomën është 5.

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

Për periudhën e të dhënave 2017-19, numri i të punësuarve jo në përputhje me diplomën është 5.

*Elton Meka*


*Kley*



Vlerësimi sipas Standardeve

| Standardet/kriteret   | Përmbushja e standardeve   |
|---|--|
| <b>IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE</b>  |  |
| <b>Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.</b>   |  |
| <p><b>Kriteri 1</b> Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>   | <p>Pranimi i studentëve është në përputhje me legjislacionin në fuqi, studentët regjistrohen në portalin e MASR dhe pasi ata shpallen fitues bëhet regjistrimi i tyre në programin e studimit.</p> <p>RVB dhe gjatë takimeve na u tha që nuk kishte kritere specifike për pranimin e këtyre studentëve nuk përmënd kritere specifike në këtë progra studimi.</p>   |
| <b>Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikën e punësimit.</b>   |  |
| <p><b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>   | <p>Procedura për informimin e studentëve është e detajuar dhe e mjaftueshme. Studentët kanë disa mundësi për tu informuar duke filluar që nga kontakti i parë me Albanian University deri tek java orientuese e çdo viti shkollor.</p> <p>Studentët kanë dy variante për të vlerësuar pedagogët: nëpërmjet një pyetësori anonim dhe nëpërmjet focus grupe ku një grupë studentësh përzgjidhet në mënyrë rastësore.</p> <p>Zyra e Këshillimit të Karrierës i ofron studentëve shërbim këshillimi si në përgatitjen e një letre motivimi ose resume-je, por në diskutimin me studentët, një numër i madh prej tyre u shpreh se nuk e kanë përdorur ndonjë herë këtë shërbim.</p> <p>Institucioni disponon disa marrëveshje ndërinstitucionale me OJF dhe institucione shtetërore ku studentët mund të përfitojnë eksperience pune nëpërmjet internship-eve. Po ashtu, Zyra e Karrierës dhe Alumnit i ofron studentëve informacion të vazhdueshëm mbi mundësi punësimi.</p> |
| <b>Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.</b>   |  |
| <p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p> | <p>Institucioni disponon statistika mbi numrin e të diplomuarve dhe e ka shtuar këtë informacion në RVB, të cilin e verifikuan edhe gjatë vizitës në IAL.</p> <p>Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar në program. Por, RVB nuk ofron statistika mbi tërheqjet ose largime para përfundimit të programit. Megjithatë, gjatë takimit me Sekretariat, ekspertëve të jashtëm ju vu në dijeni raste kur studentët kanë ndërprerë studimet dhe janë transferuar drejt një IAL tjetër.</p> <p>Sekretariati disponon të dhëna mbi ecurinë e studentëve nga fillimi deri në fund. Një vërejtje që u vu re nga ekspertët e jashtëm ishte mungesa e notës ngelëse në regjistrin e programit. Gjatë takimit me Sekretariat, ekspertëve ju shpjegua se nota 4 nuk vihet në regjister pasi ajo zëvendësohet kur studenti përsërit lëndën ose provimin.</p>   |

Elton Meka





**Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.**

**Kriteri 1** Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;

**Kriteri 2** Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.

Institucioni i ofron studentëve këshillim karriere nëpërmjet Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, ndërsa ndihma për çështjet mësimore ofrohet nga Zyra e Kordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentit. Në lidhje me këtë të fundit, RVB nuk jep asnjë evidencim në formën e një dokumenti mbështetës.

Institucioni dhe Departamenti përkatës i këtij programi ka firmosur disa marrëveshje bashkëpunimi me OJF dhe institucione shtetërore me të cilat studentët përfitojnë praktikën mësimore dhe profesionale.

**Konkluzionet e vlerësimit:**

1. Mirëpritja e studentëve të rinj nga institucioni është e detajuar dhe në përputhje të plotë me standartet.
2. Institucioni ofron informacion mbi mundësitë për punësimin me studente të cdo programi. Por në bazë të informacionit që GVJ mori gjatë vizitës në institucion konstatohet se duhet të bëhet akoma punë me këtë pjesë.
3. Statistikat e mbajtura nga zyrat përkatëse dhe nga Sekretariati ishin në përputhje të plotë me standartet.
4. Duke e ndarë kujdesin ndaj studentit në dy aspekte: aspektin e këshillimit të karrierë dhe aspektin e ndihmës mbi çështje mësimore, vihet re se standartet e këshillimit mbi karrierën janë ekzistente dhe në funksion, ndërsa aspekti i ndihmës mësimore evidentohet pjesërisht. Në fillim të çdo viti akademik studentët përfitojnë nga java orientuese dhe pajisen me Guiden e Universitetit për jetën studentore. Megjithatë, ngelet e paqartë se çfare lloji ndihme përfitojnë studentët kur ata kalojnë vështirësi me aspektet akademike të mësimdhënies gjatë vitit akademik.

**KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.****10. Kërkimi shkencor****Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Aspekti i kërkimit shkencor ishte pika më e dobët e programit. Gjatë takimit me stafin akademik u shfaq një frymë tepër negative në lidhje me kërkimin shkencor. Nga pjesëmarrësit në këtë grup, vetëm një person u shpreh se ka tentuar të publikojë në revista akademike të indeksuara në Scopus ose Thomson Reuters. Ndërkohë që një pjesë tjetër e stafit ose kishte përshtypje të gabuara në lidhje me procesin e publikimit (ku supozohesh se publikime në revista cilësore realizohej përmes pagesës) ose arsyetimet e ofruara për mungesën e publikimeve nuk ishin të bindshëm. Po ashtu, edhe lista e publikimeve që evidentohen RVB nuk janë publikuar në revista të indeksuara. Thënë ndryshe, stafi akademik, në aspektin shkencor, është përfshirë kryesisht në prezantime konferencash, por jo në publikime në revista të indeksuara sipas VKM 112

*Elton Meta*



*për tituj dhe gradat.* Megjithatë, Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative është mjaft aktiv në organizimin e aktiviteteve shkencore brenda Albanian University. Sipas RVB (Tabela 20) Albanian University ka organizuar 45 aktivitete shkencore (knoferenca, seminare, ëorkshope dhe tryeza të rrumbullakëta, ku janë përfshirë edhe 11 studentë) për programin e studimit në fjalë. Por, duhet theksuar se shumica e këtyre aktiviteteve kanë esencën e Shkencave Politike dhe shumë pak prej tyre kanë si fokus Administrimin Publik—diçka e cila lidhet ngushtë dhe me rekomandimet e ekspertëve të jashtëm mbi vlerësimin e programit në Piken 7.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Të dhëna për kërkimin shkencor (Ploteso Tabelat ne aneks)

Analiza e të dhënave për kërkimin shkencor tregon se botimet e personelit akademik janë tërësisht të publikuara ose brenda vendit ose në revista jo të indeksuara në Scopus ose Thomson Reuters. Me përjashtim të një prej pedagogëve me kohë të pjeshme i cili kishte një numër të vogël publikimesh në revista të indeksuara, askush tjetër nuk kishte diçka të tillë. Në lidhje me aktivitetet e tjera shkencore si konferencat, vihet re se ato nuk rezultojnë në punime finale të cilat botohen në revista të indeksuara. Po ashtu, aktivitetet e tjera si seminarët, ëorkshopet dhe tryezat e rrumbullakëta tregojnë angazhim shkencor, por jo domozdoshmërisht produkt shkencor. Së fundmi, numri i projekteve kërkimore të fitura dhe të zbatuara (4) janë në rang fakulteti dhe jo domozdoshmërisht përfshijnë aspekte kërkimore.

#### **11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun**

##### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Institucioni dhe Departamenti i Shkenca Politiko-Administrative disponon 14 marrëveshje ndër-institucionale me institucione brenda dhe jashtë vendit. Megjithatë, marrëveshjet janë kryesisht me institucione brenda vendit, dhe vetëm dy prej tyre janë me institucione arsimore me dy nga vëndëet fqinjë (Universitetit Ndërkombëtar në Strugë dhe ISPE Kolegj Prishtinë). Marrëveshjet e tjera janë me institucione shtetërore (si për shembull me Kuvendin e Shqipërisë ose Ministria e Brendshme) dhe OJF brenda vendit (si për shëmbull Instituti i Studimeve Politike dhe Albanian Center for Good Governance). Bëshkëpunimi është i mjaftueshëm në lidhjet brenda vendit, por ka nevojë për përmirësime me institucione jashtë vëndit. Edhe pse Albanian University disponon disa marrëveshje me institucione në Itali, këto marrëveshje nuk përfshijnë programin e shkenca politiko-administrative.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

*Elton Meka*

*[Signature]*



- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (ploteso Tabelat ne aneks)

Dallimi midis bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar vihet re në numrin e aktiviteteve të organizuara nga Departamenti i Shkenca Politiko-Administrative. Ndërkohë që departamenti ka organizuar rreth 45 aktivitete shkencore dy vitet e fundit, vetëm 8 prej tyre janë organizuar me lektorë të huaj.

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (plotëso te dhenat ne aneks)

Bashkëpunimi me institucione shqiptare, si me ato shtetërore dhe OJF është i mjaftueshëm dhe ka patur një numur të madh aktiviteteve gjatë dy viteve të fundit. Në kuadër të këtyre bashkëpunimeve, departamenti ka organizuar një sërë leksione të hapura dhe ëorkshope ose tryeza të rrumbullakëta. Në këto aktivitete janë angazhuar marrëdhëniet me Bibliotekën Kombëtare, Institutin e Studimeve Politike, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, UNDP, Lëviz Albania, Konrad Adenauer Stiftung, dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

### Vlerësimi sipas Standardeve

| Standardet/kriteret  | Përbushja e standardeve   |
|--|---|
| <b>VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME</b>   |   |
| <b>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.</b>   |   |
| <p><b>Kriteri 1</b> Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>  | <p>Institucioni ka treguar që nxit bashkëpunimin e personelit brenda institucionit duke inkurajuar pjesëmarrjen e tyre ne aktivitetë të organizuar nga institucioni, duke nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera dhe duke aplikuar për projete të përbashkëta.</p> <p>Departamenti i Shkenca Politiko-Administrative ka një ndarje të qartë të kompetencave të stafit. Ndarja e kompetencave u vu re dhe gjatë vizitës në institucion ku u evidentua edhe bashkëpunimi midis stafit akademik dhe zyrave mbështetëse (si për shembull midis stafit akademik dhe Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave), ose midis studentëve dhe zyrave mbështetëse si Zyra e Karrierës dhe Alumnit</p> |
| <b>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</b>   |   |
| <p><b>Kriteri 1</b> Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni organizon trajnime</p> | <p>Institucioni disponon vetëm një numër të vogël marrëdhëniesh me institucione jashtë vendit për sa i përket programit në fjalë. Marrëveshjet me aktorët e biznesit po ashtu mungojnë, por duke patur parasysh fushën e studimit, këto marrëveshje janë fokusuar më shumë me institucione shtetërore ose OJF.</p> <p>Institucioni ka vendosur disa marrëveshje bashkëpunimi për kryerjen e praktikës me institucione të rëndësishme në fushën e shkencave politike dhe administrative, si institucione shtetërore ose OJF të stabilizuara.</p>   |

*Epton Meka*

*teby*



|   |   |
|---|---|
| <p>profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>   | <p>Institucioni ka organizuar disa trajnime, pikërisht në fillim të vitit akademik me fokus përmirësimin e mësimshenies duke ftuar ekspertë të huaj. Por, RVB nuk evidenton raste ku trajnimet të jenë ofruar në bashkërendim me punëdhënësit.</p> <p>Zyra e Karrierës dhe Alumnit disponon statistika të numrit të studentëve që kanë përfunduar eksperiencë praktike me institucionet bashkëpunuese, por RVB nuk evidenton nëse këto të dhëna analizohen në mënyrë cilësore për të treguar përfitimet e këtyre marrëveshjeve si për studentët dhe për programin e studimit.</p> |
| <p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Institucioni disponon një numër të mjaftueshëm marrëveshjesh profesionale me institucione vendase, si ato shtetore dhe ato jo-shtetërore. Këto marrëdhënie janë reflektuar edhe në numrin e aktiviteteve të organizuara në bashkëpunim. Në këtë aspekt, institucioni është në përputhje të plotë me standartet e vendosura.</li> <li>2. Institucioni nuk disponon një numër të mjaftueshëm marrëveshjesh profesionale me institucione jashtë vendit. Edhe pse institucioni disponon disa marrëveshje me institucionet jashtë vendit, këto marrëveshje nuk përfshijnë programin në fjalë. Kjo është një dobësi e dukshme e programit.</li> </ol> |   |

## **ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

### **I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË**

Gjatë vizitave në AU na u dha të kuptojmë se institucioni ka një staf burokratik solid e për pasojë dhe zyrat e administratës funksionojnë më së miri. Përsa i përket programit në shqyrtim, patëm bashkëpunimin maksimal të stafit administrativ dhe atij mësimdhënës. Përsa i përket rekomandimeve nga akreditimi i parë, një pjesë e tyre janë plotësuar ndërsa një pjesë mbetet e pa plotësuar. Nga një analizë e kurrikulës del se program në fjalë ka një kurrikul klasike shkencash politike e gjendur rëndom në shumë universitete. Dallimi i vetëm është ai se vihet më shumë theksi tek pjesa institucionale por kjo nuk do të thotë që i është dhënë plotësisht përgjigje pyetjes kryesore të ngritur nga raporti parandës i Akreditimit. Për këtë arsye duhet punuar më fort në disa aspekte të cilat ne i mendojmë si të nevojshme. Njëkohësisht duhet parë dhe infrastruktura e brendshme. Ambientet e vizituara ishin relativisht të vjetra. Në sallën e madhe të konferencave mungonte ajrimi. Një sallë tjetër leksionesh që u vizitua ishte tejet e vjetër dhe e amortizuar. Në bibliotekë në katin e nëndheshëm ndjehej prania e lagështisë. Nisur nga sa më sipër mendojmë se insitucioni ndodhet në këtë situatë në lidhje me rekomandimet e akreditimit të parë:

a) Të parashikohet qartë në objektivat formuese të këtij programi mundësitë e parashikuara të punesimit të studentëve të diplomuar, mbeshtetur në të dhënat e punësimit të studentëve tashmë të diplomuar;

- **Plotësohet pjesëhmë:** Programi ofron objektiva formuese të qarta dhe i reflekton këto objektiva përsërisht në kurrikul. Po ashtu, Zyra e Karrierës dhe Alumin mban statistika dhe kontakte me studentët e diplomuar. Objektivat e programit janë të ndara në dy grupe: **së pari**, të specializojë dhe të përgatitë studentët për tregun e punës; dhe **së dyti**, të programi përgatitë studentët për studime të mëtejshme në fushën e shkencave politike, administrimit publik dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.

*Elton Mela*

*Aleji*



b) Të vleresohet, rishikohet dhe përditesohet plani mësimor me më shumë lëndë të profilit dhe në përputhje me zhvillimet makroekonomike të viteve të fundit;

- **Nuk plotësohet:** Edhe pse në datën 25/4/2018 Senati Akademik i Albanian University imratoi ndryshimin e kurrikulës së programit, ku ndryshim nuk është i mjaftueshëm për nevojat e programit ashtu siç rekomandohet dhe nga Këshilli i Akreditimit. Ndryshimi jo vetëm se është tepër i vogël (8.3%), por këto ndryshime reflektohen më shumë në lëndë të përgjithshme ose shkencë politike, por jo në fushën e administrimit publik. Pra, aktualisht programi ka ende vetëm një lëndë të mirëfilltë mbi administrimin publik.

c) Të rritet stafi akademik për një përputhje më të mirë të formimit akademik të tyre me profilin e lëndëve që ata mbulojnë;

- **Plotësohet pjesëshëm:** Vazhdon të ketë një mospërputhje të dallueshme midis lëndëve dhe stafit akademik. Një numur i madh i lëndëve, të cilat janë edhe lëndë vjetore, si përshembull Psikologjia Politike, Histori e Ideve Politike, Elementet e Qeverisjes dhe Proceset Zgjedhore, Filozofi Politike, ofrohen nga pedagogë me përputhje të dobët ose me aspak fushën akademike të lëndës.

d) Të merren masa për kualifikimin e stafit përmes veprimtarive të brendshme institucionale dhe mbështetjes së tyre për pjesëmarrje në projekte dhe angazhim në veprimtari kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare;

- **Nuk plotësohet:** Edhe pse institucioni ka tentuar në disa raste të përfitojë nga projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, vetëm në disa rastë kanë qenë të sukseshëm, por edhe në ato rastë fusha kërkimore ka qënë larg shkencave politike dhe administrimit publik. Në tërësi, programi ka probleme të theksuara në aspektin e kërkimit shkencor.

e) Të shtohet numri i titujve specifik të fushës së shkencave politike administrative në bibliotekë;

- **Plotësohet kryesisht:** Departamenti ka shtuar numrin e titujve specifik për fushën e studimit, por këto shtesa i përkasin fushës së shkencave politike. Sipas RVB vetëm vitin e fundit akademik janë shtuar 11 tituj. Programi po ashtu ofron akses në databazën Questia. Megjithatë, programi vazhdon të ketë një numër tepër të vogël titujsh që përfshijnë administrimin publik për rastin shqiptar.

f) Të rritet mbështetja financiare nga ana e institucionit për përditesimin akademik të stafit për natyrën specifike që ka ky program studimi dy-fushesh;

- **Nuk plotësohet:** Vazhdon të mungojë financimi nga institucioni për stafin akademik. Evidenca e ofruar nga RVB (*Evidenca 5.2*) i referohet vetëm një rasti ku një prej stafit akademik i është rimbursuar një shumë e vogël për shenzimet. Gjatë vizitës në institucion u shpreh dhe nga stafi akademik se financime të kësaj natyre nuk kishte patur.

g) Të shihet mundësia e përfshirjes më të madhe të studenteve të këtij programi studimi në veprimtaritë e Departamentit.

- **Plotësohet pjesëshëm:** Edhe pse numri i studentëve të angazhuar në veprimtarinë e departamentit është i lartë (112), angazhimi i tyre vin kryesisht në formën e pjesëmarrjes në aktivitete shkencore si konference, seminare ose ëorkshope. Përfshirja e tyre cilësore në aktivitete shkencore ngelet e e pakët, pasi edhe vete stafi akademik u shpreh se kërkimi shkencor kërkon përgatitje më të lartë, duke preferuar studentët e masterit.

*Elton Meta*

*EB*



## II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).


### a. Pika të forta:

1. Programi ka organizimi burokratik të fortë dhe mbështetjen e nevojshme nga njësitë administrative.
2. Programi përbehet nga një trup akademike tepër i zgjeruar dhe e cila duket e konsoliduar në raport me kualifikimet.
3. Programi, stafi akademik, stafi mbështetës dhe grupi studentor ka një raport të mirë me njeri-tjetrin e cila tregon dhe frymën bashkëpunuese në institucion.
4. Vendndodhja e godinës së Universitetit në qendër të Tiranës është diçka tepër pozitive e cila u sjell studenteve dhe stafit lehtësi në transport, si dhe i mban ata afër aktiviteteve të ndryshme të cilat shpeshhere organizohen rreth qendrës.

### b. Pika të dobëta:

1. Plani mësimor nuk reflekton plotësisht qëllimin për të cilin është krijuar dhe nuk ka arritur të reflektojë të gjitha rekomandimet nga akreditimi i fundit. Specifikisht këto vihen re në kurrikulën e programit, ku shumica e lëndëve nuk prekin ose prekin vetëm në mënyrë indirekte fushën e Administrimit Publik.
2. Mungon specializimi i pedagogëve në fushën e administrimit publik, zgjerimi i lëndëve të kësaj natyre, si dhe tituj specifik mbi administrimin publik, sidomos për rastin shqiptar. Me veçanti të disa anëtarëve të stafit akademik, të cilët kanë eksperiencë në administratën publike, stafi tjetër nuk ka specializim mbi administrimin publik. Kjo tregon një boshllëk të madh mbi përgatitjen e stafit akademik për këtë fushë. Po ashtu, nuk ekziston thuajse asnjë titull mbi administrimin publik në shqipëri.
3. Mungon koordinimi i punës kërkimore dhe mbështetja më e fortë financiare nga ana e Universitetit. Këto mangësi pengojnë zhvillimin profesional të stafit akademik dhe përditësimin e tyre mbi zhvillimet shkencore në fushat përkatëse. Stafi akademik nuk është i përfshirë në tentative për të publikuar në revista shkencore të indeksuara në Scopus ose Thomson Reuters. Kjo mungese penalizon të gjithë institucionin, si pedagogët të cilët nuk kanë mundur të ecin para me zhvillimet e fundit, si studentët që nuk përfitojnë dot nga pedagog të angazhuar në zhvillimet e fundit të fushave të tyre përkatëse, si dhe institucioni i cili nuk arin të thithë projekte nga jashtë të cilat do lehtësonin barrën financiare.
4. Organizimi i lëndëve vjetore (me 10 kredite) e bën të vështirë mobilitetin e studentëve si brenda apo jashtë vendit. Duke qenë se teknikisht behet fjalë për një lëndë (10 kredite) e cila është e barabartë me dy lëndë semestrale (5+5 kredite), transferimi i tyre në IAL të tjera do sillte pasoja për studentët pasi studenteve mund ti njihen vetem 5 kredite nga lënda vjetore.

*Elton Meta*





**c. Mundësitë:**

1. Përderisa kurrikula aktuala ka një mungesë të theksuar mbi lëndët e administrimit publik, programi mund të përfitojë përmes huazimit të lëndëve që mund të jenë të përshtatshme për administrimin publik, por ofrohen nga departamentet e tjera si shkencat juridike, ekonomiku, ose administrim biznesi. Diçka e tillë do sillte dhe një lehtësim financiar për programin dhe institucionin.
2. Programi mund të përfitojë nga marrëveshje ndërkombëtare si Erasmus+ për mobilitetin e studentëve dhe stafit jashtë vendit. Diçka e tillë do përmirësonte aftësitë e stafit akademik duke përfituar nga mobiliteti i tyre, dhe do u ofronte studentëve mundësinë për tu ekspozuar ndaj ideve të ndryshme dhe për të njohur me kultura të huaja.
3. Albanian University ka një mundësi të veçantë për të qenë pioner në fushën e Administrimit Publik. Është ndër të vetmet institucione që ofron një program Bachelor në këtë fushë. Edhe pse programi ende nuk i ka plotësuar rekomandimet e akreditimit të parë në këtë aspekt, institucioni ka një mundësi për të themeluar edhe vete fushën e administrimit publik në Shqipëri. Diçka e tillë, megjithatë, do kërkonte një angazhim të theksuar dhe objektiva afatgjatë.

**d. Pengesat:**

1. Mungesa e një literature të mirëfilltë të administrimit publik në shqipëri krijon pengesa si në përcaktimin e literaturës bazë për studentet si dhe në përgatitjen e lëndëve nga ana e pedagogëve.
2. Tendencë në ulje të numrit të studentëve. Kjo gjë që mund të ndikojë negativisht në mbajtjen e ruajtjen e kritereve minimale të mësimdhënies, si dhe në aspektin financiar të programit i cili financohet 99% nga tarifat studentore.

**Rekomadime:**

1. Ndryshimi i kurrikulës për të reflektuar një përmbajtje më të gjërë të administrimit publik duhet të jetë diçka mjaftë e thjeshtë. Rekomandohet që departamenti të konsultojë programe të ngjashme jashtë vendit dhe të reflektojë mbi kurrikulën. Nuk është e nevojshme për një ndryshim drastic mjafton një ndryshim brenda 20% të lejuar nga MASR. Për të ritur edhe kapacitetet njerëzore, departamenti pas identifikimit të lëndëve, mund të përcaktojë disa individë nga stafi akademik për të përgatitur lëndët e reja. Diçka e tillë do ishte në funksion të universitetit, departamentit, programit, stafit dhe studentët.
2. Programi ka një mundësi shumë të mirë për tu bërë pioner i fushës së administrimit publik në shqipëri. Për të aritur këtë qëllim, rekomandohet që programi të krijojë një grup pune për të përgatitur një numër librash bazë për administrimin publik në shqipëri. Diçka e tillë do rriste specializimin e pedagogëve në këtë fushë, dhe po ashtu do u jepte studentëve mundësinë për të kuptuar administratën publike shqiptare jo vetëm teorikisht në bazë të titujve të përgatitur për kontekste shumë ndryshe, por edhe për ta kuptuar atë në realitetin shqiptar.

*Elton Meka*





3. Duhet theksuar se të pesë pikat e dobëta kanë një ndërthurje me njëra tjetrën. Për këtë arsye, përmirësimi i secilës prej tyre, sjell përmirësim në të gjitha. Rekomandohet që departamenti dhe universiteti të rritë mbështetjen financiare për kërkimin shkencor. Ekspertet evidentuan se universiteti shpenzon mjaftueshëm mbi aktivitete shkencore ta cilat organizohen brenda institucionit, e cila tregon se ka një vizion afatgjatë. Por për ta bërë këtë vizion sa me real, universiteti duhet të investojë edhe për aktivitete jashtë institucionit. Për këtë arsye do mjaftonte edhe një buxhetim i vogël në fillim të çdo viti akademik për të mbuluar shpenzimet e stafit për aktivitete shkencore jashtë vendit si konferenca, trajnime, workshope etj.
4. Stafit akademik duhet të kuptojë së dështimi është pjesë e kërkimit shkencor. Sipas studimeve të ndryshme, afër 80% e punimeve shkencore nuk pranojnë për publikim që në tentativën e parë. Po ashtu, revistat shkencore janë të renditura nga më e mira tek më e dobëta. Rekomandohet, që në bazë të përgatitjes personale stafit të fillojë tentativat për të publikuar në revista të inteksuara në Thomson Reuters ose Scopus. Edhe në ato 80% të rasteve ku publikimi i manuskriptit refuzohet nga procesi i peer-review, ato refuzime shoqërohen me komente dhe arsye pse manuskripti nuk është pranuar. Ky proces në vetvete është një proces mësimor për gjithë autorët të cilët kanë mundësi të reflektojnë dhe përmirësojnë punimet e tyre.
5. Rekomandohet që lëndët vjetore të ndahen në lëndë simestrale. Gjatë kërkimeve me stafin akademik, ekspertëve u shpjegua se lëndët vjetore kanë një ndryshim në përmbajtje nga simestri i parë tek i dyti. Megjithatë, duke e emëruar të gjithë lëndën si një lëndë, kjo mund të sjellë studentëve vështirësi ose pasoja në njohjen e lëndëve kur ata transferohen në një IAL tjetër.

### III. SUMMARIZING ANALYSIS ACCORDING TO THE SWOT METHOD (STRENGTHS, WEAKNESSES, OPPORTUNITIES, THREATS).

#### a. Strengths:

1. The program is well organized and has the necessary support from the administrative units.
2. The program consists of a large number of staff members who appear consolidated in relation to their qualifications.
3. The program, the academic staff, the support staff and the student group have a good rapport with each other which illustrates the cooperative spirit in the institution.
4. The location of the university building in the center of Tirana is a very favorable condition. It provides students and staff with transportation convenience, and keeps them close to the various activities that are often organized around the city center.

*Elton Meka*

*[Signature]*



**b. Weaknesses:**

1. The curricula does not fully reflect the purpose for which the program was created and has failed to reflect all the recommendations from the previous accreditation. Specifically, these are noted in the program curricula, where most courses do not reflect or only indirectly reflect the field of Public Administration .
2. There is a lack of specialization from the academic staff in the field of public administration, there is a lack of courses on public administration in the curricula, and there is a lack of literature on public administration, especially for the Albanian case. With the exception of a few staff members who have some experience in public administration, all other staff do not have a sufficient specialization in public administration. This shows a big gap in the academic preparation of staff members for teaching public administration. Additionally, there are almost no textbooks on public administration in Albania.
3. There is a lack of research coordination and a need for stronger financial support from the University. These deficiencies hinder the professional development of the academic staff and their ability to remain updated on the latest scientific developments in their respective fields. According to the financial data reflected in the RVB and the meetings with academic staff, financial support for research or participation in scientific activities is almost non-existent .
4. The academic staff are not engaged in trying to publish in Scopus or Thomson Reuters indexed scientific journals. This penalizes the entire institution, such as lecturers who are not been able to keep up with the latest developments in their fields, students who cannot benefit from lecturers who are engaging in quality academic research, as well as the institution which is not able to absorb external funds which would ease the financial burden for the university.
5. Yearly courses (worth 10 credits) makes student mobility difficult. Such courses are technically a single course equivalent to two semester courses (5 + 5 credits). However, transferring such courses to other HEIs would pose challenges for students as they may only be able to transfer 5 credits from the 10 credit annual course.

**c. Opportunities:**

1. As the current curriculum has a marked shortage of public administration courses, the program can benefit by borrowing courses that may be suitable for public administration but are offered by other departments such as law, economics, or business administration. Doing so would also provide financial relief for the program and the institution.
2. The program may benefit from international agreements such as Erasmus + student and staff mobility programs. Such programs would allow the academic staff to benefit from their

*Elton Meta*

*[Signature]*



exchange experiences, and provide students with the opportunity to become exposed to different ideas and become familiar with foreign cultures.

3. Albanian University has a unique opportunity to be a pioneer in the field of Public Administration in Albania. It is one of the only institutions offering a Bachelor program in this field. Although the program has not yet met the recommendations from the previous accreditation, the institution has an opportunity to establish itself in the field of public administration. Doing so, however, will require a strong commitment and long-term goals.


**d. obstacles:**

1. The program in question is offered in the Albanian language, which penalizes the institution in establishing inter-institutional agreements with HEIs from abroad. Perhaps by making a minor change to the curriculum that would oblige English language courses for each academic year, or by offering some courses during the third year in English, the program could create opportunities for collaboration with institutions from abroad.
2. The lack of a proper public administration literature in Albania creates obstacles both in determining the basic literature for students and in the preparation of courses by lecturers.
3. There is a downward trend in the number of students enrolled in the program. This could affect teaching as well as the financial aspect of the program, which currently is 99% funded by student fees.

**Recommendations:**

1. Changing the curriculum to reflect a broader content of public administration should be simple. It is recommended that the department consult similar programs from abroad and reflect on the program curricula. No drastic change is needed — only a 20% change as allowed by MASR. To increase human capacities, after identifying the courses to be added, the department may appoint some individuals from the academic staff to prepare the new subjects. Something like this would benefit the university, department, program, staff and students.
2. The program has a great opportunity to become a pioneer in the field of public administration in Albania. To achieve this goal, it is recommended that the program establish a working group to prepare a number of basic public administration books in Albania. Doing so would enhance the specialization of lecturers in this field, and would also give students the opportunity to understand Albanian public administration not only on the basis of works prepared for very different realities, but for the Albanian context as well.
3. It should be noted that all five weaknesses are intertwined. For this reason, improving one of them brings about improvement in all. It is recommended that the department and university increase

*Elton Mehta*





financial support for scientific research. The experts noted that the university spends sufficiently on scientific activities organized within the institution, which shows that it has a long-term vision. But to make this vision more realistic, the university must also invest in activities outside the institution. For this reason, a small budget at the beginning of each academic year would be sufficient to cover staff costs for scientific activities abroad such as conferences, trainings, workshops, etc.

4. Academic staff should understand that failure is part of scientific research. According to various studies, about 80% of scientific papers are not accepted for publication in the first attempt. Likewise, scientific journals are ranked from best to worst. It is recommended that based on their personal training, staff members begin attempting to publish in Thomson Reuters or Scopus indexed peer-reviewed journals. Even in those 80% of cases where the publication of the manuscript is rejected by the peer-review process, those rejections are accompanied by comments and reasons why the manuscript was rejected. This process itself is a learning process for all authors who are then able to reflect and improve their work.
5. It is recommended that annual courses be divided into semester courses. During the discussions with the academic staff, it was explained to the experts that the annual courses differ in content from the first to the second semester. However, by naming the whole course as a single course, it can cause students difficulties or consequences in recognizing the subjects when they are transferred to other HEIs.

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm**

**Dr. Klejdi Kellici**

**PhD Eltion Meka**

*Eltion Meka*

